 Në 30 raste është operuar syri i djathtë dhe në po aq raste syri i majtë. Vetëm 7 të sëmurë janë operuar në të dy sytë. Goniotrepana-cioni u krye në të gjitha llojet e glaukomës. Rastet tona paraqiteshin si më poshtë:

Glaukoma me kënd të hapur (*Glaucoma chronicum simplex*) 42 raste, glaukoma me kënd të ngushtë (*Glaucoma chronicum congestivum*) — 2 raste, glaukoma me kënd të mbyllur (*Glaucoma acutum*) — 3 raste, glaukoma dytësore (*Glaucoma secundarium*) — 5 raste, glaukoma e li-ndur (*Buphtalmus*) — 8 raste.

Glaukoma kronike e thjeshtë kishte kaluar 4 herë në stadin *quasi absolutum*. Glaukomat dytësore tri herë, si shkak i rritjes së tensionit të brendshëm të syrit ishte trauma e syrit. Një herë paraqiste një ciste të trisit dhe një herë *Aphaki*.
 Nga ekzaminiimi objektiv rezultoi se 4 sy kisishin demtims korneale, nga të cilët dy herë *Nuhecula* dhe dy herë *Leucoma cornea*. Në dy sy të tjerë, korneja paraqiste edemë. Në 17 sy dhoma e përparme paraqitej e cekët, në 34 normale dhe në 9 raste e thelle. Këndi i dhomës në 45 raste ishte i hapur, në 12 i mbyllur dhe në 3 i ngushtë dhe me ngji-tje (*synechie*). Në dy raste, bejba ishte në midriazë pothuaj maksimale me formë jo të rregullt. Në rastet e tjera, bejba e syrit ishte e rumbur-ilakët, gendrore e në pjesën më të madhe pa reaksion në drite nga një mjekim i vazhduar me pilokarpinë. Në një sy kishte ngjitje të pasme të trupi gelqor ishte i tejdukshëm, kurse papila e nervit të të parit 22 herë ishte me ngjyrë rozë pa të thelluar, në 21 raste me të thelluar pak të

Kristalina në 16 raste paraqiste turbullim të pjesshëm të formave të gjera atrofike, në iris.

Shprehur dhe në 17 raste e thelluara e papilës ishte e gjërë dhe para-gitej e çngjyrosur.

Fusha e pamjes në 10 ishte pa demtims. Në 18 raste me ngushtim të shprehur sipër nga ana e hundës dhe në formë rrethore, nga të cilat 8 herë i atrohej pikës së fiksimit. 15 herë të sëmurë të ndryshëm e femijë nuk gene në gjendje të jepnin të dhënat e duhura. Në 17 raste fusha e pamjes nuk i bashkëngjittej karteles klinike. Tensioni i syve në shtrim paraqitej si më poshtë:

Pasqyra nr. 2

24.38 mm Hg deri 31.61 mm Hg (Schlotz) — 6 raste, 31.61 mm Hg deri 41.38 mm Hg — 19 raste, mbi 41.38 mm Hg — 35 raste.	Gjendja e pamjes në shtrim ishte si tregohet në pasqyrën nr. 2.
--	---

Gjatë operacionit, me përjashtim të dy rasteve, përparësja sklerale është formuar gjithmonë lart dhe trespahimi është kryer në orën 12. Në 49 raste u përdor trepan Elliot 1.5 mm dhe në 11 raste 1.75 mm të zgjedhur në varësi nga shiritat e tensionit të brendshëm të syrit në ditën e operacionit.

Në të 60 rastet u krye iridektomia bazale. Ndërlikimet gjatë ndër-hyrjes nuk ishin të rëndësishme. Ajo që mund të mos kryhet e pletë është prerja e «tapës» sklerale, gjë që më pas vazhdon të kryhet lehtë nën mikroskop me majtën e thikës së Graetes ose me gërshërën kor-neale.

Zbrazja e dhomës së përparme ngadale mënjanon vershimin e trisit jashtë. Dajta e tij e paket dhe prerja pa e tërhequr bën një iridektomi të vogël e të vendosur pranë rrenjës së trisit. Me këto qëndrohet larg Elliot-it. Këtë e parandalon edhe kryerja e operacionit të plagosjes së kristalinës, që përshtkruhet si ndërlikim i operacionit të tensionit të brendshëm të syrit, që lekunden rreth 30 mm Hg.

Në tri raste, në dhomën e përparme kishte gjak të shpërndarë, që një herë është larguar me shpëlartje. Mënjëherë pas qepjes së për-parses sklerale, fillon dhe formimi i dhomës së përparme. Ndërlikimet pas operacionit të goniotrepanacionit janë relativisht të pakta. Në ma-terialin tone ato u vepëjken në 18.3% të ndërhyrjeve.

Të nesërmen e operacionit, në 53 sy (88.3% e rasteve) dhoma e për-parme ishte e riformuar. Në 3 raste (5%) dhoma e përparme qendroi e cekët. Në 3 raste (50%) dhoma ishte me e thelle, kurse në një rast ajo mungoi, dhe kjo u bë shkak që të krijohej një turbullim i rumbullakët i kornesë në formën e *karattiti nga kontakti*.

Mostormimi i dhomës së përparme edhe pas 10 ditëve bëri të nevoj-shme largimin e kristalinës së tejdukshme. Futja e ajrit, sipas përvojës së disa autorëve, në këto raste mbetet pa dobi.

Në rastin tonë, largimi i kristalinës u bë që poshtë anash pa pre-kur fistulën e krijuar. Qysh në castin e largimit të kristalinës ndodhi kthjellimi i menjëhershëm i kornesë, gjë që na betasoi. Mbushja e dho-

pfjese të rregullit sklerale, me përmasa të caktuara, që bëjnë të mundur një lloj «dozim» të operacionit dhe, ajo çka është më e rëndësishme, dhe të bëjnë një vlerësim më të drejtë të rezultateve të operacionit, gjë që mbetet më e vështirë në operacionin e trabekulektomisë sipas Cairns-it, ku gdo herë katërkëndëshi i dytë, që largohet, mund të ndër- rojnë formën, përmasat dhe vendosjen.

Dorëzuar në redaksi më 10.11.1984.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Busse H., Kuchle H.J., Wahnig A.: Langzeitbeobachtungen nach Goniotrepnacione mit Skleradekel, Klin. Mbl. Augenheilk. 1984, 4, 251.
- 2) Kolozsvari L.: Trabekulektomie beim Buphthalmus. Lkin. Mbl. Augenheilk. 1983, 6, 503.
- 3) Pham-Duy T., Ihme A.: Sicherkeitsformen und Druckregulierung nach Trabekulektomie, Klin. Mbl. Augenheilk. 1983, 3, 166.
- 4) Riss B., Binder S.: Retrospektive auf 402 Goniotrepnacionen. Klin. Mbl. Augenheilk. 1980, 2, 286.
- 5) Schnaudigel O.E.: Langzeitergebnisse nach Gedeckter Goniotrepnacion (Elliott - Fionimopoulos), Klin. Mbl. Augenheilk. 1984, 3, 202.
- 6) Starov N.A., Draganska: Filtrierende Trepano-trabekulektomie mit Schwammartiger Narbe. Klin. Mbl. Augenheilk. 1984, 1, 55.
- 7) Zhughl S.: Glaukoma parsore. Drefjoria e Arsimiit Shëndetësor. Tiranë, 1983.

Summary

GNOTREPNACION AND ITS POSTOPERATIVE RESULTS

The paper describes the Fionimopoulos operation, which is a trepanation in the angle of the chamber according to Elliott, but is covered by a scleral lid. It gives the results of the operation performed in 60 cases suffering from all various types of glaucoma. The youngest patient, only one month of age, had buphthalmus. Analysing the complications occurring during and after the operation, the author notes that he has observed plain subconjunctival filtration in 63,30% of his patients, which is the main route leading to the normalization of the eye pressure achieved in 96,70% of the cases.

According to the author, trabeculectomy performed with atrepan allows the removal of a regular part of the sclera of predetermined dimensions, which makes possible a sort of «dosage» of the operation, allows other surgeons to perform the almost identical intervention, and creates the possibility of a more correct evaluation of the results of the operation.

mës me ajër e formoi atë. E sëmurë, edhe një vit e gjysëm pas ndër- hyrjes, ka dhomë të thellë. Papila e nervit të të parit — pa të thelluar dhe ngjyrë rozë të zbehtë. Syri ruan një pamje 0,8 me syze, kurse tensioni i brendshëm i syrit është 17,3 mm Hg.

Në 5 raste u vu re Hyphema në ditët e mëvonshme, e cila vetëm një herë lidhet me traumën e syrit. Në një rast, mbi iris kishte mbetur një koaguli gjaku, që u thith. Në dy raste (3,30%) me dhomën e cekët u vu re Ablatio chorioideae, që më vonë u ul dhe nuk lindi nevoja për të ndër- hyrë. Në një rast u vu re iriti pas operacionit, që u mposht me midrriatike, pomadë hidrokortizon dhe kompresa të ngrohta. Në një sy të operuar, filtrimi nën konjunktivë qëndroi i shtuar për 15 ditë, nga liri i një suture të përparës sklerale. Në dy raste papila qëndroi e tërhequr.

Në kontrollin në dalje, në 38 sy (63,30%), filtrimi nën konjunktivë ishte i shprehur. Ky filtrim zakonisht është i shpeshtë. Ai nuk sho- gërohet më tej nga jashtë kë polikistike (3).

Në 22 raste të tjera (36,70%) me sy nuk vërehet filtrim nën ko- njuktivë.

Më anën e goniotrepnacionit ishte e mundur ulja e tensionit të syrit, sig duket në pasqyrën nr. 3.

Pasqyra nr. 3

Mbl 24,38 mm Hg — 1 rast
20,55 mm Hg — 1 rast.
17,30 mm Hg — 6 raste
14,30 mm Hg e më pak 31 raste.

Syri në palpacion i butë në 21 raste.
Pamja e syve paraqitet si në pasqyrën nr. 4.

Pasqyra nr. 4

Në rikontrolle të mëvonshme të të sëmurëve, u vu re se tensioni i syrit nuk ulet nën 28,9 mm Hg me njëkrim, prandaj u përërit goniotrepnacioni sipër, nga ana e jashtme, kurse në një rast ai mbahet nën shifrat 20-22 mm Hg me dy herë plokarpinë, që, së bashku, përfaqësojnë 3,30% të rasteve. Ditëqëndrimi mesatar pas operacionit ka qenë 9,68 ditë.

Vizus	Të sëmurë
0,02	9
0,03 — 0,1	10
0,2 — 0,3	7
0,4 — 0,5	7
0,6 — 1,0	19
nuk kuptojnë	8

Nga sa më sipër, arrijmë në përfundimin se: Goniotrepnacioni i mbuluar me kapak skleral i Fionimopoulos është një ndërhyrje mikrokirurgjike e parapëlqyer për trajtimin e glaukomes, që në 96,70% të rasteve tonë ka sjellë normalizimin e ten- sionit të rritur të syrit që është edhe arsyeja kryesore që shpie në rruajtjen e funksioneve të tij.

Kryerja e trabekulektomisë, në këtë mënyrë, lejon heqjen e një

R e s u m e

GONIOREPARATION ET LES RESULTATS POSTOPERATOIRES

L'auteur décrit l'opération de Frommopoulos, qui consiste dans la réparation de l'angle de la chambre selon Elliot, mais couvert d'un couvercle scléral. L'article expose les résultats de l'opération chez 60 cas atteints de divers types de glaucomes. Le plus jeune des malades, âgé d'un mois, avait buphtalmus. Après avoir analysé les complications pendant et après l'intervention, l'auteur observe qu'il a constaté dans 63,3% des cas une filtration plate subjonctivale, selon l'auteur, la trabeculectomie effectuée avec trépan, donne la possibilité pour faire la suppression d'une pièce sclérale, ayant des dimensions déterminées, pour faire «le dosage» de l'opération et aussi pour faire l'appréciation plus exacte des résultats des opérations.

NEKREKTOMIA E HERSHME — METODE ME PEPARRESI PER TRAJTIMIN E TE DJEGURVE RISHTAS

— KSHM. GËZIM PEPI — ISLAM DAVTI —

(Instituti Kërkimor i Mjekësisë Ushtarake)

Në trajtimin e të djegurve, ka marrë përparësi përdorimi i nekrektomisë së hershme, si një metodë mjafte e mirë për shpëtimin e jetës së tyre, për shkurtrimin e kohës së qëndrimit në spital dhe mosinvalidizimin e tyre (1, 3, 4).
Nuk ka patologji tjetër në kirurgji ku organizimi të ketë për një djegur (5, 6, 7).
Në qoftë se ulja e konsiderueshme e vdekshmërisë në përdudhën peritondhën septiko-toksike, shkurtrimi i kësaj përdudhe (transformimi në klasifikim të saj), si dhe parandalimi ose shfaqja e paketit e në forma të lehta të një sërë ndërlikimesh të sëmundjes së djegjes i kushtohen në radhë të parë trajtimin kirurgjik, krahas atij kompleks e konservativ (4, 8, 9).

Studimi dhe njohja e thellë e ndryshimeve lokale që ndodhin në pjesët e djegura, krahas atyre të përgjithshme, nxorri si nevojë të mosdosime ndërprerjen sa më shpejt që të jetë e mundur të humbjeve të plazmës, elektroilitëve dhe të nxehësive, gjë që u arrit në sajë të nekrektomisë së hershme. Për të kryer nekrektominë e hershme, bazohemi në gjendjen e përgjithshme të të sëmurëve, në thellësinë e plagës, në maddësinë e shtrirjes së saj si dhe në zonën e vendosjes.

Partimisht djegjet e shkallës II të thellë dhe ato të shkallës III kanë nevojë për trajtim kirurgjik. Djegjet e shkallës II, për arsye se infektohen dhe kalojnë në shkallë III, i operojmë, ndërsa djegjet e shkallës III, kur diagnostikohen qysh në fillim, i nënshtrohen trajtimin kirurgjik të menjëhershëm.

Gjatë trajtimit kemi pasur parasysh disa pjesë të tilla si hapësira midis gishtërinjve, qsetullave, pjesët anësore të gjoksit, rejonet in-guinale etj., sepse demtimet që fillimisht janë sipërfaqësore shndërrohen në të thella nga lagështia gjatë mjekimit të zgjatuar dhe së, kur trajtohen me metoda koservative, lënë kontraktura të mëdha dhe demtime funksionale që kërkojnë ndërhyrje rekonstruktive me disa faza dhe me pasoja për të sëmurin.

Operacioni i nekrektomisë së hershme qëndron në largimin e indeve nekrotike dhe shndërrimin e plagës së djegur në plagë të pastër kirurgjike, si mbulimin e saj me autodermotransplant.


Nekrektomia e hershme ka këto epërsi:
 — Me heqjen e indeve nekrotike, largon burimin e toksinave me veprimtari të shtuar proteazike, si terren ideal për rritjen e shumëzimit e mikroorganizmave. Në këtë mënyrë, pakësohet shumë rezekun i septi-kotozemisë nga djegia dhe njëkohësisht bëhet i mundur aktivizimi i mekanizmave imune.
 — Duke ulur veprimtarinë proteazike, përmirëson balancin azotik nëpërmjet rritjes së fazës anabolike të metabolizmit dhe, si rrjedhojë, pakëson rënie në peshë të të djegurve.

— Shkurton në mënyrë të ndjeshme qëndrimin në spital (mesatarisht 10 ditë) dhe shmang pasojat e papëlqyeshme funksionale dhe kozmetike, që mund të lindin nga mbyllja e vetëveshme e plagëve të djegura.


— Pakëson humbjet hidroelektrolitike, proteinike dhe ato të nxeh-tësise (kaloreke) nga plagët e djegura. Si në klinike edhe në eksperiment, është vërtetuar se humbja e 20 g proteinë/m² sipërfaqe të djegur gjatë 24 orëve ulët rreth 75 për qind pas nekrektomisë së hershme të shogë-ruar me auto—, homo— dhe heteroplastike.

Nga përvoja jonë, rezultoi se koha më e përshtatshme për kryerjen e këtyrëve operacioni është 3-5 ditë pas traumës termike. Në këtë periudhë të sëmurët kanë dalë plotësisht nga gjendja e shokut të djegies dhe është vendosur një ekuilibër hidroelektrolitik i përshtatshëm, janë përfunduar plotësisht edemat, është korrigjuar acidozat dhe është rivendosur volemia normale, si dhe nuk është shfaqur ende infeksioni i shprehur në plagën e djegur, kushër këto të domosdoshme për të marrë rezultatet e duhura. Në repartin tonë, nekrektomia si metodë mjekimi e kemi filluar që në vitin 1975. Deri ditën e sotme kemi operuar 203 të djegur, shpërndarjen e të cilëve në varësi nga sipërfaqja e djegur po e para-qesim në grafikun nr. 1. Moshat e tyre ka gënjë nga 1-60 vjeç me mbi-zotërim të moshës 15-40 vjeç si në grafikun nr. 2.

Qëndrimi mesatar në spital i këtyrëve kontingjenti është mesatarisht 19,5 ditë (nga 7 ditë deri 60 ditë). Në këtë drejtim është ndjekur parimi i nekrektomisë së hershme, e cila përgjithësisht është realizuar në ditën e 3-5 pas djegies. Në një kontingjent prej 38 vetash, ajo u krye që në momentin e ardhjes. Rezultatet e këtyrëve grupi janë nga më të mirat, me një ditëpshim mesatar prej 11,5 ditësh. Në 52 raste, qëndrimi i vonuar në spital ka ardhur si pasojë e ndërlikimeve të përgjithshme. Këto ndërlikime kanë përfshirë: infeksione mushkërtore 41 veta, qelbë-zime të plagëve 17 veta, gjendje septike 11 veta.
 Vdekshmërinë e kemi pasur 8%, në 17 veta. Shkaqet e vdekjes kanë qënë: në 10 veta me insuficiencë vaskulare, në 4 veta infeksione të rënda mushkërtore dhe në 3 veta insuficiencë veshkore akute septiko-toksike. Në trajtimin konservativ vdekshmëria ka qënë 13%. Nga ana-liza e materialit tonë klinik, në krahasim me trajtimin konservativ, rezultojnë 7 ditë qëndrimi më pak në spital (dijëndrimi mesatar në spital për trajtimin konservativ është 26,7 ditë).



GRAFIKU NR 1



Rastet sipas moshës


GRAFIKU NR 2

gind të sipërfaqes së trupit. Diten e katërt pas djegies, i sëmurit i nënshtruhet nekrektomisë së hershme tangjenciale në 20 për qind të sipërfaqes së trupit. Biopsia e indëve të hequra tregon që indet e djegura ishin me dukuri nekrotike dhe inflamatore. Nuk iu bë autodermoplastikë, pasi u ruajtën elementet epiteliiale të lekures dhe ankesave të saj. Në materialin e marrë nga plaga, izolohet stafillokoku dhe proteusi, të ndjeshëm ndaj gentamicinës dhe tetraciklinës. Perfuzionet u dhënë nëpërmjet kateterit subklavian që u mbajt 10 ditë pa ndonjë ndërlikim. Te ky i sëmurë nuk u shfaq gjendja septiko-toksike. Ai qëndroi në spital 33 ditë.

Nekrektomia e hershme tangjenciale e kemi zbatuar në të gjithë djegiet e thella të shkallës II. Ajo kryhet shtesë pas shtresë deri sa bindemi që kemi hequr gjithë pjesën nekrotike nga plaga e djegur dhe mbërrijmë në kuti me indet e shëndosha, gjë që kuptohet nga fillimi i hemorragjisë kapilare (*en nappe*). Në djegiet e thella të shkallës II ruhen elementet epiteliiale të domosdoshme për epitelizimin e lekures. Për këtë arsye, plaga nuk mbulohet me autodermograftant. Nekrektomia rrenjësose qëndron në heqjen e indëve nekrotike deri në kuti me facien ose me muskujt. Si metode rrenjësose, ajo është njëkohësisht edhe traumatike për të sëmurin dhe rëndon gjendenjen e tij. Frandaj kryerja e nekrektomisë së hershme rrenjësose kërkon marrjen e një sërë masash për stabilizimin e plote të gjendjes së të sëmurëve me parametrat klinike dhe fiziko-biologjike, sigurtimin e një rezerve të domosdoshme gjaku, që do të përdoret në këtë rast; po ashtu, marr rëndësi edhe anestezia e zgjedhur sipas rasisit. Nga të dhënat e literaturës (5, 6, 9), duhen nga 122-150 ml gjak për çdo 1 për qind të sipërfaqes së trupit të djegur që i nënshtruhet nekrektomisë së hershme tangjenciale ose rrenjësose, kurse në, për këto raste, kemi përdorur 100 ml gjak, pa pasur dukuri të hipotonisë arteriale apo të shokut hipovolemik. Veg kësaj, në rastet tona me nën 5 për qind të sipërfaqes së trupit të djegur që i janë nënshtruar nekrektomisë së hershme nuk kemi përdorur fare gjak, përjashtuar rastet kur kanë gënë femijë dhe pleq. Në vend të tij kemi përdorur tretësira të tjera zëvendësuese. Jo pa vlerë është përcaktimi i madhësisë së sipërfaqes së djegur që do t'i nënshtruhet nekrektomisë gjatë një seance të dhënë. Zakonisht kjo sipërfaqe mund të mbërrijë deri 20 për qind të sipërfaqes së trupit, ashtu sig e kemi për mungesë të lekures së hollizuar.

Taktika e mbullimit — menjëherë ose pas 1-2 ditëve — të kësaj sipërfaqje të plagës e krijuar me autodermoplastikë në formë ishujsht të vegjël ose të mëdhenj varet nga disa faktorë: nga shkalla e pastritimit të indëve nekrotike, nga mundësia e realizimit të një hemostaze shumë të mirë, e cila, veg të tjerave, realizohet me kompresë të mxehta me tretësirë fiziologjike sterile, si edhe nëse zbulohen gjatë operacionit strukturat e thella anatomike, si muskujt, tendinet, kockat, nervat, enët të gjakut etj. Sig dihet, secila prej tyre ka specitike për sa i përket mbullimit me plastikë; autodermoplastikë e vonuar pas nekrektomisë së hershme do të bëhet pas 2-3 ditëve, por jo më vonë, sepse shtohet rreziku i inflamacionit të plagës, duke kompromentuar vetë metodën operatorore dhe duke ulur vlerën e saj.

Të djegurit janë operuar me narkozë të potencuar, anestezia brenda-kockore dhe pleksiale, shpimorë dhe peridurale e deri në anestezia lokale sipas rasisit e shpërndarjeve jepen në grafikun nr. 3.



Punën tonë po e ilustrojmë me rastet e mëposhtme:

I sëmurit A.C., 20 vjeç, me peshë trupore 70 kg, me djegie të shka-llës II-III në 45 për qind të sipërfaqes së trupit, shtrohet në gjendje shoku kombustional. Ai u trajtua në 24-orëshin e parë me 11 litra tretësirë ringer laktat, 750 ml tretësirë bikarbonat natrumi 8.4 për qind, 2 litra tretësirë glukozë 20 për qind, 1 liter glukozë 10 për qind dhe një liter glukozë 5 për qind, të shogëruar me sasinë e nevojshme të insulinës. U përdorën hemacelë, vitamina të ndryshme, koenzimë «A», lanatocid «C», testasteron, propionat, eutilinë, oksigjen, SAT, penicilinë e kristalizuar etj. I sëmurit mori 17 litra lëngje nëpërmjet kateterit sub-klavian.

I sëmurit kishte PVC 8 cm të shtyllës së ujit, urinoi 5 litra me peshë specifike 1025-1030. Në 24-orëshin e dytë sasia e lëngjeve u për-gjysma dhe në ditët e tjera u shtua në terapi plazmë, infuzaminë, in-tralipidë, gjak etj. Ai u nënshtrua nekrektomisë së hershme ditën e katërt, kur iu bë 20 për qind e sipërfaqes së trupit me autodermoplastikë me ishuj. Gjatë operimit mori dy litra gjak. Në terapi iu filluan gëra-mitine dhe tetran 5 ditë, hepatoprotektor, gamaglobulinë, gjak, plazmë etj. Pas 25 ditësh e vendosën edhe disa ishuj të tjerë auto-dermetraplant. Si ndërlikim pati bronkopneumoni dhe kondrit të veshit të djathtë. Në kulturën e marrë nga plaga u izoluan bakterit kולי, sta-filokok dhe proteus. Doli i shëruar pas 63 ditë mjekimi.

I sëmurit V.N., 43 vjeç, shtrohet në klinikën tonë tri ditë pas një aksidenti me benzine, me djegie të shkallës II të thellë në 45 për

- 4) *Benned J.E.*: A Twelve Years Experience with Early Excision of the Burns Wound. New York, 1978, 76.
- 5) *Bondock G.C.*: Primary Surgical Management of the Deeply Burned Hand in Children. The American Jour. Surg. New York, 1967, 21.
- 6) *Dauti I.*: Djetet dhe trajtimi i tyre. Simpoziumi i kirurgjisë në IKMU. Tiranë, 1979.
- 7) *Janzkovic Z.*: A New Concept in the Early Excision and Immediate Grafting of Burns. The Journal of Trauma. 1970, 10, 12, 1103.
- 8) *Pepi G.*: Nekrektomia e hershme, konceptet moderne të aplikimit të saj. Referat në seminarin I kombëtar për problemet e djegjeve më 15 maj 1979.
- 9) *Xhuka K.* Dëna koncepte të reja për trajtimin e të sëmurëve të djegur gjatë dy ditëve të para. Referat në seminarin kombëtar për problemet e djegjes. Tiranë, 1979.

Summary

EARLY NECRECTOMY — A PRIORITY METHOD IN THE TREATMENT OF RECENT BURNS

Apart from the advantages of early necrectomy in the treatment of burns, the paper describes the indications of the technique. Details are also given of the method in its tangential as well as in its radical variant with auto-dermograft. The practical results of the method, which has been used for the past 10 years in our Institute, are given. The paper ends by describing in detail 2 typical cases in autodermograft were performed.

Résumé

LA NECRECTOMIE COMME UNE METHODE DE CHOIX DANS LE TRAITEMENT DES BRULURES RECENTES

L'article décrit les indications de cette technique qui est qualifiée de choix dans le traitement des brûlures récentes. En outre les auteurs donnent des détails sur la méthode, sur ses variantes tangentielles et radicales avec autodermogreffe. L'article met en évidence les résultats pratiques de cette méthode appliquée dans l'Institut depuis déjà 10 ans. Enfin on présente deux cas typiques ayant subi une necrectomie radicale avec autodermogreffe et necrectomie tangentielle.

Duhet të kemi parasysh që fushat e marrjes së autodermotransplacit, të cilat si rregull përdoren për 1 ose më shumë seanca, të plantifikohen me kujdes dhe ekonomik. Kjo e rrit vlerën sidomos kur operojmë mbi sipërfaqet artikulare, të cilat detyrimisht duhen mbuluar me transplantat të trashë dhe copë të madhe, me qëllim që të mos lënë pasojë pas operacionit, si kontraktura, ulcera trojike etj.

Kur operojmë anësitë, detyrimisht përdorim shgutin, i cili pakëson në mënyrë të konsiderueshme humbjen e gjakut. Në rastet e zbulimit të menjës së plagës, pas nekrektomisë së hershme duhet llogaritur që ajo e fundit të zbulohet sa të jetë e mundur në shumë mënyra të përpunshme dhe të sëmurëve. P.sh., në djegjet e shkallës II, deri në 10 për qind të sipërfaqes së trupit, pas stabilizimit të gjendjes së përgjithshme, bëjmë Brenda një seance nekrectomine e hershme dhe autodermotransplacitë me mbulim përfundimtar të plagës së pastër kirur-gjike të krijuar në vendin e djegjes.

Ndërsa kur kemi djegje të gjera në mbi 40 për qind të sipërfaqes së trupit, përsëri nekrectomia e hershme nuk ka asnjë kundërlidhim dhe mbetet e vetmja metodë për shpëtimin e jetës së të sëmurëve. Në këto raste ajo pëlenzohet me seanca, qdo 2-5 ditë nga një operacion në të tretin, duke llogaritur që ndërhyrjet të kenë përfunduar brenda dy javëve të para pa traumës termike. Nuk duhet hartuar që keto procese dura traumatiqe realizohen vetëm nën një terapi intensive rehidruese, gjak, plazmë, antibioterapi sipas kultures së marrë nga plaga apo hemo-kultures, vitaminoterapi, kardiotonike, mjekim të kujdesshem me anti-septike lokale, mjedis të pastër etj.

Zbatim i autodermotransplacitës — e, krahas saj, i homo- e hetero-plastikes dhe veganoristit i lekures së llojlizuar si mbulesë biologjike e perkoshme — shkojnë shumë mundësitë e rritjes së suksesit për trajtimin e këtyre të sëmurëve.

P e r f u n d i m e

1) Nekrektomia e hershme ka një avantazh të dukshëm në krahasim me trajtimin konservativ, duke shkurtuar ditët e qëndrimit në spital në 7,2 ditë më pak dhe ulur vdekshmërinë nga 130% në 80%.

2) Nekrektomia e hershme duke u bërë ditën e parë na dha përfundime të mira duke përmirësuar ditëqëndrimin në spital 8 ditë më pak.

3) Indikacionet për nekrectomi të hershme duhet të zgjidhen mirë dhe të shqetësohen me kompleksin e masave për keto raste.

BIBLIOGRAFIA

- 1) *Andrea A.*: Mbi septicemine kombustionale. Shëndetësia popullore. 1978, 3, 41.
- 2) *Artz K.P.* et coll.: Major Body Burns. JAMA. 1975, 12, 223.
- 3) *Artnuson G.* et coll.: A New Topical Agent for the Early Treatment of the Burned Hand. Burns, 1978, 4, 225.

PERGJIGJIA E APARATIT KARDIOVASKULAR NDAJ VEPRIMTARISE FIZIKE DHE STRESIT TERMIK

— MMYNYR RESULI — KSHM. SABIT BROKAJ —

(Instituti Kërkimor i Mjekësisë Ushtareke)

Gjate veprimtarisë fizike të kryer në mjedis të nxehë të organi-
zëm, ndodhin mjaft ndryshime fiziologjike dhe biokimike. Gjithashtu,
në kushte të përshtatshme të mjedisit të jashtëm, shkaktohet hedhje
e sasive të mëdha të gjakut në muskujt skeletor. Kur veprimtaria fi-
zike zhvillohet në kushtet e temperaturës së lartë të mjedisit, vëllimi
i gjakut venoz rritet, por pakësohet mbushja ventrikulare dhe vëllimi
goditës (2, 3). Ndryshimet që ndodhin në organizëm bëhen akoma më të
mprehta kur njeriu mban veshje të vegante që pengon largimin e tem-
peraturës së trupit. Për të vërejtur përgjigjen e aparatit kardiovaskular
dhe qëndrueshmërinë e organizmit në rrethana të tilla, ne kryem një
studim, një pjesë të të cilit po e paraqesim më poshtë:

KUSHTET, MATERIALI DHE METODA E STUDIUMIT

Studiimi u krye në kushtet e mjedisit të jashtëm me temperaturë
31°C, lagështi 71% dhe presion barometrik 762 mm Hg. Në një mjedis të
tillë in nënshtruan veprimtarisë së rëndë fizike 39 të rinj të shëndoshë
me moshë 20-22 vjeç. Ata ishin të veshur me kostume të posagme plotë-
sisht të mbyllura, nga koka deri në këmbët, që pengonin ajrimin e të-
kurës dhe përcjelljen e temperaturës trupore në mjedisin e jashtëm.
Frymëmarrjen e realizonin nëpërmjet kundërrgazit. Këta të rinj kishin
kryer edhe më parë ushtrime në kushte të tilla, me qëllim përshtatje
të organizmit. Ushtrimet fizike dhe qëndrimi në këto kushte zgjatën
mesatarisht 32.8 min. Si tregues të aparatit kardiovaskular u ndoqën
pulsit dhe presioni arterial (P.A.).

Të dhënat e këtyre treguesve u morën para ngarkesës fizike dhe
Te dhënat e këtyre treguesve u morën para ngarkesës fizike dhe
para dhe në minutën e pestë dhe të dhjetë pas ndërprerjes së ngarkë-
sës. Ekzaminimet u kryen në pozicionin shtrirë. P.A u mat me aparat
me zhivë.

Te dhenat janë paraqitur në pasqyrën nr. 1. Nga pasqyra vërehet se, në të gjitha rastet e ekzaminuara në minuten e dytë pas ndërprerjes së ngarkesës fizike, ka shpeshësisht të rrahjeve të zemrës me një ndryshim mesatarisht 73 rrahje mbi atë të pushimit. Në minuten e pestë pas ndërprerjes së ushtrimit dhe heqjes së veshjes së poscsm, puls i ra në vlerat fillëtare në 18 vete, kurse në 11 vazhdonde të ishte mbi 90 minuta. Pas minutës së dhjetë të ndërprerjes së vepimitarise, puls i ra në vlerat fillëtare gati në të gjitha rastet. Vetëm në një rast ai ishte mbi 90 min.

Ndryshime pati edhe në vlerat e presionit arterial. Ndryshime më të dukshme pati veganërisht presioni arterial diastolik. Në disa rastet ai ra deri 20-30 mm Hg poshtë vlerave fillëtare (ato të parangarkesës fizike). Në të shumtën e rasteve, ky ndryshim u vërejt në ekzaminimin e minutës së pestë pas ndërprerjes së ngarkesës fizike. Në këtë kohë, fillëtare. Në minuten e dhjetë pas ndërprerjes së ushtrimit, presioni arterial sistolik vetëm në një rast ishte nën vlerat fillëtare, ndërsa në rastet e tjera ai ishte në vlerat e parangarkesës ose deri 5 mm Hg më lartë. Në dy rastet ndodhi hipotimi. Ata u gëtesuan shpejt pas vendosjes në pozicionin shtrirë. Në këto rastet, presioni arterial në kohën e ekzaminimit ishte 80/50 mm Hg dhe 80/52 mm Hg.

D I S K U T I M

Në kushtet e vepimitarise fizike dhe ndikimit të njëkohshëm të stresit termik, sistemi kardiovaskular përballon një ngarkesë të madhe. Në cilindo gjendje që të ndodhet organizmi, ky sistem pershtatet në sate të mekanizave kompensues. Kur vepimitaria fizike kryhet në mjedis të nxehtë, mekanizmat kompensues dhe mundësitë e sistemit kardiovaskular për t'u përshatur dhe përballuar punën fizike nuk realizohen në gjithanshmërinë dhe plotëshmërinë e tyre. Kjo ndodh për arsye se ato kundërshtohen ose nuk zhvillohet dot plotësisht nga ndryshimet ose dukuritë që ndodhin në organizëm, nga ndikimi i temperaturës së lartë të mjedisit. Puna muskulare, kur kryhet në kushte të përshatshme për organizmin, gon në hedhje të sasive më të mëdha të gjakut drejt muskulave që punojnë (8). Në këto rastet, zhvillohet e ashtu quajtura hipëremi ushtrimore (9). Rryma e gjakut në muskujt ndryshon pohnajse në përpjesim të drejtë me shkallën e rëndesës së punës. Në pushim, ajo është 1 ml në minutë për 100 gr muskul dhe rritet mbi 20-40 herë gjatë ushtrimit fizik të fuqishëm (1).

Në kushtet e eksperimentit tonë, ku të rinjtë kanë peshë trupore 70 kg dhe masë muskulore rreth 30 kg, në vepimitari të rëndë fizike, të natyres ecje dhe ushtrime të ndryshme u takon të vënë në punë 2/3 e masës muskulare. Në këtë rast, rryma e gjakut që shkon në muskujt llogaritet të jetë mbi 4 litra në minutë. Kur vepimitaria fizike kryhet në mjedis të nxehtë, në organizëm ndodhin ndryshime që e pakesojnë vëllimin e gjakut. Nxehtësia e jashtme zakonisht e zvogëlon

Diferencën e temperaturës midis mjedisit të jashtëm dhe sipërfaqes së lekures, si dhe midis lekures dhe brendësisë së trupit (6). Kjo diferencë bëhet akoma më e vogël në kushtet e veshjes trupore që pengon përçelljen e nxehtësisë prej trupit, në mjedisin e jashtëm. Humbja e nxehtësisë trupore nëpërmjet avullimit do të pengohet, pasi zvogëlohet diferenca e presionit midis sipërfaqes së lekures dhe mjedisit mbi të. Njëkohësisht, edhe largimi i nxehtësisë së temperaturës trupore në këto kushte është Rryga e vetme e uljes së temperaturës trupore në këto kushte është djersitja. Për shkak të djersitjes së fuqishme pakësohet vëllimi efektiv i lengjeve të trupit. Të gjithë personat që lu nënshtruan kësaj ngarkese fizike dhe termike për 32 minuta humbën nga 2 deri 6 kg peshë. Vetëmimi efektiv i lengjeve të trupit pakësohet edhe në rrugë tjetër. Kur- nizesi më i madh i energjisë për tkurrjen muskulare gjatë vepimitarise fizike është glikogjeni i vendosur dhe i grumbulluar në muskujt. Me zbehtëhimin e glikogjenit ose lëndëve të tjera formohen shumë nën- produkte të vogla të ndërmetme. Megjensë cipa qelizore është relati- visht më pak e tejprerkrueshme ndaj prodhimeve që lindin nga zbehtë- himi i glikozes në krashasin me atë të ujit, brenda qelizës musku- lare prodhohen forca osmotike të fuqishme, të pakten gjatë pertudhës së hershme të punës fizike (7).

Zbehtëhimi i glikozes shkakton lëvizjen e ujit prej plazmës brenda qelizave muskulare. Si pasojë e humbjes së pakitë të nxehtësisë trupore, temperatura e brendshme e organizmit ngrihet. Kjo nxit rritjen e më- tejshme të punës së sistemit kardiovaskular për arsye se:

a) sistemi kardiovaskular duhet të dergojë sasi më të madhe gjaku në muskujt që janë në aktivitet, për të bërë të mundur një shkëmbim më të madh gazez, do të çojë oksigjen dhe do të marrë gazin karbonik të grumbulluar aty, si dhe do të heqë prej andej nxehtësinë shesë të prodhuar në muskujt që punojnë;

b) ai do të sigurojë një rrjedhje më të madhe të gjakut në lekure për të furnizuar me ujë gjëndrrat e djersës që janë në aktivitet të lartë (6).

Nxehtësia e prodhuar nga puna muskulare dhe e shkaktuar nga mjedis i nxehtë dhe vegante perçillet nëpërmjet gjakut, në zemër e prej këtej në qendrat e hipotalamit. Si përgjigje nga këto qendra dërgohen impulse për zgjerimin e enëve të gjakut dhe shtrimin e prodhimit të djersës. Skuqja e lekures së trupit, si shfaqje e zgjeri- mit të enëve të gjakut dhe djersitja e fuqishme, ishte e pranisime në të gjitha rastet tona. Bshhtë gjetur se për çdo 0.01°C ngritje të tem- peraturës trupore, rryma perçitërike e gjakut rritet afërsisht 15 ml në minutë. Kjo përgjigje nuk kontrollohet prej temperaturës së gjakut që arrin në hipotalamin e përparshëm (4).

Zhvillimi i vepimitarise fizike në kushtet e veganta të eksperimentit tonë me dukuritë që e karakterizojnë atë (djersitja e madhe, zgjerimi i enëve të gjakut etj.), shkakton rënie të presionit arterial, i cili vazhdoi të ishte i pranishëm në 50% të rasteve të studiuara, edhe në minuten e pestë pas ndërprerjes së ngarkesës fizike dhe termike. Në të njëjtën mënyrë duhet interpretuar fakti, që, edhe në pjesën tjetër të grupit të marrë në studim, nuk u vërejt ngritja e zakonshme e presionit arterial që ndodh gjatë vepimitarise fizike, në përpunhje me shkallën e saj.

Më shumë u ul presioni arterial diastolik. Kjo dukurti mendojnë se shkaktohet për arsye se përgjigja e ngushtimit të enëve të gjakut, që është e zakonshme gjatë punës fizike, si dhe rezistenca periferike e tyre nuk arrijnë të zhvillohen kur puna kryhet në mjedis të nxehët. Dihet se rezistenca e enëve të gjakut është faktorit bazë në mbajtjen e presionit arterial diastolik.

Një autor (10) ka gjetur se rritja e temperaturës së gjakut në fillim shqetësohet me shtim të debitit të zemrës dhe paksim të rrymës së gjakut që shkon në organet e barkut pasi rritet rezistenca e enëve të gjakut të këtyre organeve. Kjo bën të mundur që në muskujt që punojnë të shkojë sasi më e madhe gjaku (5). Në çdo minute mund të rishpërndahet 600-800 ml gjak prej organeve të brendshme drejt lëkurës (3). Për këto mekanizma nuk arrijnë të zëvendësojnë gjithmonë humbjet e lëngjeve dhe rritjen e kapacitetit të enëve të gjakut që shkaktohet nga zgjerimi i atyre të muskujve skeletor dhe të lëkurës.

Atësia e zemrës për të rritur debitin është e kufizuar. Në këto rrethana ajo realizohet kryesisht nëpërmjet rritjes së shpehtësisë së rrahjeve, por kjo është e mjaftueshme vetëm në fillim (8). Gjatë ushtrimeve fizike të zgjatura në mjedis të nxehët, rryma e gjakut drejt organeve të brendshme pakësohet vazhdimisht deri në 70-80% të sasisë së tij (10). Për pasojë, ndodh edhe dëmtimi i funksionit metabolik të mëjgës, veshkave dhe organeve të tjera.

Një nga përgjigjet qendrore të garkullimit të gjakut, ndaj rënies efektive të vëllimit të gjakut arterial dhe të pakësimit të kthimit venoz është shtimi i shpehtësisë së rrahjeve të zemrës. Ky është një nga mekanizmat kompensues për të ruajtur në nivel të përshtatshëm debitin kryesor. Në të gjithë grupin që studiuam gjatë rritje të shpehtësisë së pulsit në minuten e parë pas ndërprerjes së ngarkesës fizike. Në gjysmën e rasteve pulsi nuk ishte normalizuar edhe në minuten e pestë pas ndërprerjes së ngarkesës fizike dhe termike.

Në ngarkesën fizike të lehtë deri mesatare, shtimi i rrahjeve të zemrës dhe i kthimit venoz mund të mos lejojë rënien e debitit të zemrës. Kur shpehtësia e rrahjeve të zemrës do të arrijë vlerat më të larta, gjë që ndodh vecanërisht në ngarkesë të madhe fizike, vëllimi i goditjes dhe debiti i zemrës do të bjerë, do të ndodhë ulje e presionit nga të nxehit (9). Me ndërprerjen e veprimtarisë fizike, si dhe me përmirësimin e shkëmbimit të nxehëtisë së trupit me mjedisin pas heqjes së kostumit izolues, tregësit klinikë të funksionit të sistemit kardiovaskular vendosen shpejt në vlerat e mëparshme.

P E R F U N D I M E

- 1) Kur njeriu kryen punë fizike të rënda dhe njëkohësisht i nënshtrohet stresit termik ndodhin ndryshime në sistemin kardiovaskular, që shtaqen me luhajtje në vlerat e pulsit dhe presionit arterial.
- 2) Në kushtet e eksperimentit tonë, mjaftuan të dhënat e pulsit dhe presionit arterial për të ndjekur gjendjen e sistemit kardiovaskular.
- 3) Megjithëse ngarkesa fizike dhe termike është e rëndë, nga të rinjtë e shëndoshë ajo mund të durohet për rreth 30 minuta.

KUSHTET E MJEDISIT DHE TË DHENAT E PULSIT TË PRESIONIT ARTERIAL (P.A)

Tabela nr. 1

Të e mjedisit të jashtëm	P u l s i				P . A						
	Para ngarkesës	1-3 min. pas ngarkesës	5 min. pas ngarkesës	10 min. pas ngarkesës	Para ngarkesës		10 min. pas ngarkesës				
					D	S	D	S			
31°C	71°C	54-82 x=66 n=8 Cv=12%	128-156 x=139 n=8 Cv=6%	60-110 x=84 n=14 Cv=17%	60-96 x=71 n=11 Cv=15%	85-130 x=107,3 n=10 Cv=9%	55-90 x=70,5 n=8 Cv=11%	80-150 x=105 n=17 Cv=16%	50-80 x=67 n=8 Cv=9%	90-130 x=114 n=10 Cv=9%	50-80 x=70 n=8 Cv=11%

Shtëpit: x = mesatarja

= shprehja standardë.

Cv = koeficienti i variacionit.

Résumé

REPONSE DE L'APPAREIL CARDIOVASCULAIRE A L'EFFORT
PHYSIQUE ET AU STRESS THERMIQUE

L'activité physiques associée au stress thermique produit dans l'organisme des changements physiologiques et biochimiques.

Dans ces conditions, chez un groupe de personnes jeunes et saines, on a étudié la réaction de l'appareil cardiovasculaire, ainsi que la résistance de l'organisme humain.

Les exercices physiques ont été effectués dans une haute température de l'environnement. Les jeunes volontaires portaient des habits spéciaux empêchant la transmission de la température.

Comme indices de l'appareil cardiovasculaire étaient le pouls et la pression artérielle avant et immédiatement après l'effort physique. Le premier examen a montré une accélération du pouls. On a observé aussi des modifications de la pression artérielle particulièrement de la pression systolique avec une chute de 20-30 mmHg. Les chiffres du pouls et de la pression artérielle sont devenus normaux après 10 minutes de repos.

4) Ndryshimet e pulsit dhe presionit arterial që shfaqen nga kjo ngarkesë rrikthehen në vlerat e mëparshme plotësisht deri në minutën e dhjetë pas ndërprerjes së ngarkesës.

Dorëzuar në redaksi më 15.8.1984.

BIBLIOGRAFIA

1) Barcroft H.: Circulation in Skeletal Muscle. New York, 1963, 1353.
2) Braunwald E., Yoshua W.: The Cardiomypathies and Myocardites. New York, 1984, 1445.
3) Grover F.R.: The Influence of Environmental Factors on the Cardiovascular System. New York, 1982, 1663.
4) Hellon R.F. and coll.: The Influence of Age on Peripheral Vasodilatation in a Hot Environment. 1964, 20, 384.

5) Knoche P.V.: Clinical Physiology of Heat Exposure ne: Clinical Disorders of Fluid and Electrolyte Metabolism. New York, 1980, 1519.
6) Komug M.: Komponentet fiziolozjike te veprimtarise fizike. Perthim i Institutit te Lartë te Kulturës Fizike, Tiranë, 1975, 100.
7) Michael C.K. and coll.: The Heart in Heat Stroke. 1969, 77, 324.

8) Petersdorf G.R.: Alteration in Body Temperature, Harrison's Principles of Internal Medicine. New York, 1984, 53.
9) Thomas F. and coll. The Circulatory Abnormalities of Heat Stroke. London, 1972, 287.
10) Rowell L.B.: Human Cardiovascular Adjustment to Exercise and Thermal Stress. 1974, 54, 75.

Summary

RESPONSE OF THE CARDIOVASCULAR SYSTEM TO PHYSICAL EFFORT
AND THERMIC STRESS

Under conditions of physical activity and thermic stress, the body undergoes a number of physiologic and biochemical changes.

To assess the response of the cardiovascular system and the resistance of the human organism to these factors, a study was undertaken among a group of healthy young people. The physical exercises were carried out in a high temperature environment. The young people were dressed in special suits preventing heat conduction.

The cardiovascular indices considered were the pulse and the blood pressure before and immediately after the physical effort. The first examination showed an acceleration of the pulse. Changes were also observed in the blood pressure, particularly in the systolic pressure which fell by 20-30 mmHg. The values of the pulse and the blood pressure returned to normal after a rest of up to ten minutes.

NDERLIRIMET E «ZEMRES MUSHKËRIORE KRONIKE»

— Doc. ĆESK BROKU —

(Spitali i rrethit — Krujë)

«Zemra mushkëriore kronike», një sëmundje mjaft e shpeshtë dhe që intereson kryesisht moshat e larë, me gjithë përparimet e bëra këto dy dekadat e fundit, veganerisht në drejtim të sqarimit të patologje- nezes, të diagnozës së hershme dhe të mjekimit, prapëseprapë parqet akoma ecurt të rëndë, invaliditet të rëndë dhe vdekshmëri të lartë (7). Të dhënat mbi shpeshësinë e saj janë akoma jo të plota dhe kjo edhe për faktin se, deri në fundin e viteve 70, ajo nuk figuronte si sëmundje më vete në nomenklaturën e sëmundjeve dhe të shkakqeve të vdekjes. Janë botuar të dhëna se ajo zë 5-10% të sëmundjeve organike të zemrës (7), ndërsa autorë të tjerë këtë përqindje e japin në 7-10% (12). Një autor (4) jep të dhënat se kjo sëmundje, e shkaktuar nga bronkiti kronik dhe emfizema, në disa vende të Europës përbën rreth 40% të sëmundjeve kongjestive të zemrës. Në një punim toun (8), të kryer në material nekrptik, «zemra mushkëriore kronike» përbente 17,9% të vdekjeve nga sëmundjet kardiovaskulare. Në materialin që po paraqet- sim ajo zë 6,60% të vdekjeve në të gjitha moshat, nga të cilët 11,60% të moshës së rritur dhe 0,47% të moshës femnore.

Ecuria e sëmundjes shpesh herë keqësohet dhe shpejtohet nga ndër- likimet e shpeshta, që në shumtë raste janë të lidhura ngushtë nga pikëpamja patogjenike me vete sëmundjen, ndërsa për disa raste të tjera kjo lidhje supozohet që të jetë e tillë, megjithëqë jo gjithmonë janë sjellë argumente bindëse.

MATERIALI

Është marrë për studim material nekrptik i viteve 1957-1980 — i kryer pranë Shërbimit të Anatomisë Patologjike të Spitalave Tiranë, sot Shërbimi Qendror i Anatomisë Patologjike — i përbërë nga 8966 raste, nga të cilët 4745 të moshës së rritur dhe 4253 të moshës femnore. Duke u mbështetur në kriteret mortologjike të njohura dhe në të dhënat klinike, janë gjetur 596 raste të «zemrës mushkëriore kronike», që për- bëjnë 6,60% të të gjithë materialit. Nga këto, 553 janë gjetur në moshat e rritura dhe vetëm 43 raste në moshën femnore. Nga ky material janë nxjerrë ndërlikimet trombebolike dhe ato gastrointestinale dhe të mëlgisë.

shëtur në materialin nekropsik, trombozat në këto sëmundje i ka gjetur në 29 raste ose 12,80%, nga të cilat 19 ose 8,40% në zemrën e djathtë dhe 10 ose 4,40% me lokalizim në periferi. Nga trombozat me lokalizim në zemrën e djathtë, 17 ose 7,50% kanë gjenë në aurikul dhe nga 1 ose 0,40% në atrium dhe ventrikul.

Trombozat nuk janë ndërlikime vetëm të «zemrës mushkërtore kronike», por edhe të shumë sëmundjeve të tjera, dhe veganisht të sëmundjeve kongjësive kronike të zemrës. Këtë fakt e kemi vënë në dukje në një punim të mëparshëm tonin me bp. (10).

b) TROMBEMBOLITË MUSHKËRTORE

Janë ndërlikime mjaf të shpeshta, veganisht të sëmundjeve kongjësive të zemrës dhe, në rastin konkret, të «zemrës mushkërtore kronike». Në materialin që po paraguesim i kemi gjetur në 55 raste ose 9,20%, nga të cilat 27 i kemi konsideruar si shkak imediat të vdekjes, dhe të dhënat klinike. Në punimin e mëparshëm (9) këto ndërlikime i kemi gjetur në 11,00%, ndërsa një autor tjetër (6) në 9,30%.

Kjo përqindje është mjaf e lartë e trombeve dhe tromembolive, që lidhen ngushtë nga ana patogjenetike me ecurinë e sëmundjes, tërheq vëmendjen në drejtim të një trajtimi më të kujdesshëm me anti-koagulante dhe antiqregante.

c) NDBRLIKIMET GASTROINTESTINALE

Në materialin tonë paraqiten mjaf të shpeshta dhe meritojnë vëmendje të veçantë, jo vetëm sepse rëndojnë tablonë klinike, edhe ashtu mjaf të komplikuar, pasi gjenden në shumicën e rasteve në fazat e avancuara të dekompensimit kardiorespirator, por edhe sepse, në disa raste, ato vetë mund të bëhen shkak vdekjeje. Këto ndërlikime shfaqen me kuadrin morfologjik-klinik të gastroduodeniteve, ulcerave gastroduodenale dhe të gërryerjeve të shumëfishta të stomakut, me hipertrofi dhe theksim të relievit të mukozës, mbinxjerrje të muskult shu-morrtagji të lehta. Gastroduadeniti kronik — i shfaqur morfologjikisht me shishtë venozë (pasive) me mbushje dhe përdredhje të rrjetit venoz, hemorragji në trajtë pikash dhe, në mjaf raste, edhe me gërryerje të mukozës — është gjetur në shumicën e rasteve të sëmundjeve me dekompensim të zgjatuar të zemrës së djathtë. Fatkeqësisht, nuk kemi gjetur asnjë klinikë të gastroduodenitit, pasi si lletë-përcjellëset për në autopsi, ashtu edhe kartelat klinike nuk kanë pasur të dhëna të plota për këtë patologji. Kjo përligjet me faktin se, me të drejtë, vëmendjen e klinikës dhe tërheq me shumë simptomatologjia kardio-respiratore sesa vartëra, megjithëse disa autorë (1) i trajtojnë, por pa dhënë shpeshësime të Nderlikime relativisht të shpeshta të sëmundjes janë edhe ulcerat gjetur në 100% të rasteve.

Ndryshimet morfologjike më të rëndësishme kushtëzohen nga staza venozë kronike e organeve si pasojë e dekompensimit të zemrës së djathtë. Ato shprehen zakonisht në mëlqi me rritje të saj nga staza venozë kronike gjer në tablonë e plote të *hepar moschatum*, stazë kronike të shprekës, veshkave, trurit dhe të gjithë organeve të tjera, edhe ma perimaleolare, dhe, sipas rasti, edhe me hidrotoraks, hidropertikardium, hidropertitonum dhe rralle herë edhe me anasarke. Këto ndryshime, në shkalëzime të ndryshme, janë të detyrueshme për «zemrën mushkërtore kronike» të dekompensuar, por, krakas tyre, ndodhin edhe ndryshime të tjera që, megjithëse janë të shpeshta dhe të lidhura ngushtë nga pikëpamja patogjenetike me sëmundjen, nuk janë të detyrueshme për kuadrin morfologjik të saj. Këto ndryshime rënditen në ndërlikimet e sëmundjes që rëndojnë ecurinë e saj dhe që jo rralle bëhen shkak imediat i vdekjes. Duke i renditur sipas shpeshësisë, këto ndërlikime i kemi ndarë në: a) tromboza; b) trombemboli mushkërtore; c) ndërlikime gastrointestinale dhe g) ndërlikime të mëlgse.

a) TROMBOZA

Është ndërlikim i lidhur ngushtë nga pikëpamja patogjenetike me ecurinë e sëmundjes dhe ngjet në fazën e dekompensimit të zemrës së djathtë, pasi në këtë fazë krijojnë të gjitha kushtet për formimin e saj, ashtu siç janë paraqitur nga klasifiket e anatomisë patologjike. Këto kushte gjendrojnë në ngadalësimin e rrjedhjes së gjakut venoz (staza venozë kronike), ndryshimet fiziko-kimike të përbërjes së gjakut, që ulja e P_{O_2} (hipoksemisë), ngritja e pH, poliglobulisë dhe ndryshime të timiti i endotelit të venave nga hipoksemia dhe fibroskleroza. Kjo e fundit është gjendje e rëndomte jo vetëm në të sëmurët me «zemrën mushkërtore kronike», që në shumicën e rasteve janë të moshave të avancuara, por në të moshuarit në përgjithësi, saqë mund të thuhet se fibroskleroza është «mplakë» e venave. Ashtu si arterioskleroza, «mplakë» e arterieve.

Në 596 raste e «zemrës mushkërtore kronike», të gjetura në materialin nekropsik të studuar, tromboza është takuar në 70 raste ose 11,70%, nga të cilat në 24 ose 34,20% është lokalizuar në zemrën e djathtë, duke u vendosur 20 në aurikul, 3 në atrium dhe 1 në ventrikul. Shpeshësia e lokalizimit shumë më të lartë në aurikul shpjegohet nga ndërtimi dhe pozita e saj, që krijojnë kushte më të përshatshme për stazën e gjakut në të se sa në sektorë të tjerë të zemrës. Të 64 raste e tjera të trombozës ose 65,70% e tyre janë gjetur në venat periferike, kryesisht në pikset pelvike (peritërine, perivezikale dhe periprostatike). Në një punim të mëparshëm mbi «zemrën mushkërtore kronike» (9), të mbeshtetur mbi 6591 nekropsi, tromboza është gjetur në 62 raste ose 13,40%, nga të cilat 24 ose 38,70% në zemrën e djathtë dhe 38 ose 71,2M në pikset venozë të lartpërmendura. Një autor (6), duke u mbë-

gastrointestinale. Në materialin e studuar, ato i kemi gjetur në 37 raste ose 6,0%. Nga këto, 6 raste kanë gënë shkak imediat i vdekjes së shkakuar nga hemorragjia e rëndë gastroduodenale. Në një studim mëparshëm (9), i kemi gjetur në 4,40%, ndërsa autorë të tjerë tanët (1), në 36 raste të zgjedhura nga 507 të sëmurë me «zëmër mushkëtorë kronikë» të ekzaminuar me kontrast, i kanë gjetur në 8 raste. Në një punim morfologjik (6) janë gjetur në 4,40%. Autorë të tjerë (2) në studim klinik të 50 të sëmurëve me bronkit kronik dhe emfizemë, të ekzaminuar me sonde, rëndënogjati dhe metoda të tjera, ulcerën e kanë gjetur në 80% të rasteve, ndërsa në 160% të tjerë e kanë interpretuar si shumë të mundshëm dhe të mundshëm. Po kështu, disa autorë (cituar nga 12) shprehën se një numur i konsiderueshëm të sëmurësh me sëmundje kronike të mushkërive kanë ulcera gastroduodenale. Nga 195 të sëmurë të tillë që punonin në industrinë qymyrgjurore, në 54 prej tyre (rreth 27,70%) mbi moshën 40 vjeç kanë gjetur ulcerë gastro-duodenale. Për këtë arsye, ata rekomandojnë që, në të sëmurë të tillë të bëhen kontrole të rregullta për ulcerë.

Të dhëna të tërthorta mbi shpeshësinë e madhe të ulcerave gastro-duodenale në të sëmurët me bronkit kronik jep edhe një autor tjetër (5), i cili paraget të dhënat e një studimi të bërë në të gjithë popullsinë e Kopenhagënit, ku është vënë re se të sëmurët me ulcerë të stomakut vësin shumë më shpesh nga bronkiti kronik ndërsa ata me ulcerë të duodenit — nga cirroza e mëlçisë dhe kanceri i pankreasit. Gërryerjet e stomakut, që shqyrojnë ose jo gastroduodenitet kronike dhe ulcerat gastroduodenale, janë gjithashtu dëmtime morfologjike të shpeshta, që në i kemi gjetur në 38 raste ose 6,20%. Ato kanë pasur pamjen e defekteve të cekta e të shumëllojta të mukozës, me forma kryesisht të rrumbullakta apo venoze, me madhësi jo më shumë se 0,3 x 0,5 cm, me fund hemorragjik apo të mbushur me lëndë me pamjen e llumit të kafesë. Në shumë raste kemi gjetur edhe gjak të pakët, të lire, të përzier me mukus.

Patogjenezë e këtyre ndryshimeve, veganerisht ajo e ulcerave gastro-duodenale, nuk është shpjeguar akoma në mënyrë të kënaqshme, megjithëse ka një lidhje patogjenetike ndërmjet «zëmërës mushkëtoreset kro-nike» të dekompensuar dhe ndërlikimeve të lartpërmendura. Kjo lidhje patogjenetike është veshitur të vlihet re, veganerisht në rastin e ulcerave gastroduodenale, duke pasur parasysh se sëmundje e fundit ka një shpeshësi të lartë, veganerisht në moshat mbi 40 vjeç, ku shfaqet shumica e rasteve me «zëmër mushkëtoreset kronike». Në vijë të përdërmitshme, pa u futur në hollësi të etipatogjenës së ulcerave, këto shkaktohen nga faktorë të shumtë patogjenë që prishin ekuilibrimin ndërmjet veprimit të acidit e pepsinës dhe rezistencës së mukozës gastroduodenale. Shtimi i sekretimit të acidpëpsinës apo ulja e rezistencës së mukozës, ose veprimi i tyre i përbashkët është mekanizimi kryesor i lindjes së ulcerave (5). Duke parqitur të dhënat e literaturës (1), disa autorë theksojnë se hipoteza më e mundshme është ajo e mbivëprimitarisë gjëndërrave mbiveshkore, që, sig dihet, shfaqet në sekretim të lehtë gastrik. Kjo hipotezë gjën një mbështetje në faktin se në personat me sëmundje kongjestive të zëmërës, ashtu sig e kemi konstatuar edhe në materialin tonë, gjendet shumë shpesh hipertrofi

e këtyre gjëndërave, madje jo rrallë edhe në trajtë nyjore, që duhet konsideruar si shprehje e stresit kronik të cillit i nënshtrohen këta të sëmurë. Predispozimin e këtyre të sëmurëve për ulcera e kanë vënë në dukje edhe autorë të tjerë (2), duke shkakuar mbisekretimi të stomakut edhe me provën e histaminës në 30,80% të rasteve të ekzaminuar, të përbertë prej të sëmurësh me bronkit kronik dhe emfizemë të mushkëtrave, ndërsa në grupin e kontrollit kjo provë ka gënë pozitive vetëm në 16,60%.

Sigurisht që në zinxhirin patogjenetik një rol të rëndësishëm luan edhe staza venoze kronike e stomakut dhe e duodenit, që së bashku me hipokseminë e përgjithshme, ulin furnizimin në oksigjen dhe, si pasojë, edhe vitalitetin dhe rezistencën e mukozës së tyre kundërshtarëve të ndryshëm ulcerogjenë. Sig rezultion nga të dhënat e autorëve të lartpërmendur, si edhe nga të dhënat tona, kjo shpeshësi rrethivisht e lartë e ulcerave gastroduodenale, gastroduodenitëve dhe gërryerjeve nuk mund të konsiderohet si një bashkeshogërim i rastit.

g) NDERLIKIMET E MËLÇISË

Janë ndërlikime që duhen pasur parasysh, sepse, megjithëse më të rralla se të tjerat, mund të kenë pasojë serioze. Është fakti i mirënjohur se në të sëmurët me dekompensim të zëmërës, pra edhe në «zëmërën mu-shkëtoreset kronike», ngjasin detyrimitsh dukurit të venozës kronike të shkëtoreset kronike, ngjasin detyrimitsh të tablonë e plotë të *hepar noschnum*. Shkallëve të ndryshme deri në tablonë e plotë të *hepar noschnum*. Gjate këtyre ndryshimeve, ngjet distrofi vakulare (hidropike), koktrir-zore dhe yndyrore e qelizave të mëlçisë, kryesisht e atyre me lokalizim centroacnoz, që mund të thellohen deri në nekrobizë dhe nekrozë të disave prej tyre. Këto ndryshime morfologjike, sipas rëndësës së tyre, shfaqen edhe në funksionin e mëlçisë dhe tablonë klinike. Më shpesh në këtë temë, kanë vënë në dukje subjktër në 1,80% të rasteve. Por rritja e bilirubinemisë, që shfaqet me subjktër dhe deri me iktër të qartë, shkaktohet edhe nga hemoliza masive që ndodh në infarktët hemorra-shtaktohet edhe nga mushkërive, të cilat, sig dihet, janë mjaft të shpeshta në këtë sëmundje.

Ndërlikimi më serioz i «zëmërës mushkëtoreset kronike» në mëlçi është cirroza e saj. Në materialin e studuar cirrozën e kemi gjetur në 8 raste ose 1,30%. Që cirrozat e gjëtura kanë gënë kardake, me prejardhje nga venostaza kronike dhe jo cirroza shogërruse të karakterit tjetër e kemi vërtetuar nga ndryshime morfologjike të gjëtura në to. Në rastet e përgjithësi të lemtuar ose lehtësisht të koktrizuar, me trashje të lehtë fibrotike të kapsulës së tyre dhe në seksion me zgjerim shumë të shprehur të venave të mëlçisë, si edhe vatra fibrotike të shpërndara në mënyrë të gërgjullit. Në ekzaminimin mikroskopik mbizotëronë ti-proza centro acinoza dhe rrallë herë është parë ndërthurja e saj me ti-prozë të lehtë periportale. Indi i mëlçisë (qelizat) rreth vatrave

fibrotike ka pasur pamje të zakonshme, vende-vende me pamje të hipertrofisë dhe rigjenerimit të qelizave parenkimatoze, por pa formim strukturash nyjore. Të gjitha rastet me citrozë janë gjetur në persona me ecuri të gjatë të sëmundjes së dekompensuar dhe që në anamnezë kanë pasur shtrime të shpeshta, me përvindha kompensimi dhe dekompensimi. Një nga këto raste ka përfunduar në komë mëgjore dhe ekzaminimi histologjik ka vënë në dukje citrozë të tipit kardiak.

Dorëzuar në redaksi më 8.6.1984

BIBLIOGRAFIA

- 1) *Adhami J., Dakou P., Shyti V.*: Kompilacionet digjestive në Cor Pulmonale Chronicum. Buletini i UT-Seria shkencaat mjekësore, 1970, 2, 167.
- 2) *Avora O.O., Kapor C.P., Sobri P.*: Study of gastrointestinal Abnormalities in Chronic Bronchitis and Emphysema. Am. J. Gastroent. 1968, 50, 289.
- 3) *Feldman T.N., Ingram H.R.*: Chronic Cor Pulmonale. Ne: Hurst W.J. «The Heart». New York, 1978, 1484.
- 4) *Friedberg K. CH.*: Disease of the Heart. Third Edition. Philadelphia, London. 1969, 1551.
- 5) *Grossman I.M.*: Peptic Ulcer. Ne: Cecil «Textbook of Medicine» Fifteenth Edition Philadelphia, London, Toronto 1979, 1502.
- 6) *Koka A.*: Kompilacionet dhe shkaget e vdekjes në Cor Pulmonale Chronicum. Referim i mbajtur në simpoziumin mbi «Cor Pulmonale, Chronicum», Tiranë, 1968.
- 7) *Ross V.J.*: Chronic Cor Pulmonale. Ne «Hurst. W. J.» The Heart. New York, 1982, 1243.
- 8) *Rroku C.*: Disa konsiderata statistike mbi vdekjet nga sëmundjet kardiovaskulare, Buletini i UT-Seria shkencaat mjekësore, 1970, 1, 169.
- 9) *Rroku C.*: «Zemra mushkëriore kronike (Cor Pulmonale Chronicum)» Studim morfologjik mbi faktorët etiologjikë, ndërlikimet dhe shkaget e vdekjes në materialin nekropsik të viteve 1957-1975. Punime morfologjike, 1979, 1, 81.
- 10) *Rroku C., Telegrafi E.*: Trombembolizimi pulmonar. Buletini i UT-Seria shkencaat mjekësore, 1980, 2, 25.
- 11) *Stepakova J.C.*: Profilaktika e legënoe legënoje i legënoseredënoje nedostatoznosti. Tashkent, 1969, 103.
- 12) *Zarubina J.A.*: Hronigeskije nespeçificheskie pnevmonii. Ne: Voprosi legënoje patologii i legënoogo serdca. Kiev, 1962, 24.

Summary

Among 8966 necropsies of all ages, the author has found 594 cases of «chronic cor pulmonum», constituting 6.6% of all the causes of death; of these, 11.6% were adults and only 0.47% were children. Thrombosis was found in 70 cases or 11.7% lung thromboemboly in 55 cases or 9.2% and the morphologic picture of gastro-duodenitis in almost all the cases. Gastroduodenal ulcer was found in 37 cases or

THE COMPLICATIONS OF CHRONIC COR PULMONUM

6.0% gastric erosions in 38 cases or 6.2% and liver cirrhosis of cardiac origin in 8 cases or 1.3%. Analysing that material, the author makes comparisons with previous publications by other authors. In the discussion on the pathogenesis of these changes, particularly of the gastroduodenal ulcers, the author supports the thesis of chronic venous stasis due to «decompensated chronic cor pulmonum» by impairing the vitality of the gastroduodenal mucosa, probably by unbalancing the resistance to gastric acid and pepsin of the gastroduodenal mucosa, the mechanism of which is not yet fully explained.

Résumé

LES COMPLICATIONS DU «COEUR PULMONAIRE CHRONIQUE»

Pendant la période 1957-1980, l'auteur a étudié 8966 nécropsie de tous les groupes âges. De ce nombre, il a trouvé 596 cas atteints du «cœur pulmonaire chronique», soit 6,6% de tous les causes des décès; de ceux-ci 11,6% étaient de l'âge de l'adolescence et 0,47% de l'âge de l'enfance. La thrombose est trouvée dans 70 cas, soit 11,7%, la thromboembolie du cœur dans 55 cas, soit 9,2%, tandis que le cadre morphologique est trouvé presque dans tous les cas. L'ulcère gastroduodénale est trouvé dans 37 cas, soit 6,0%, les érosions de l'estomac dans 38 cas, ou 6,2%, et la cirrhose du foie de l'origine cardiaque dans 8 cas, soit 1,3%.
A ce qui concerne sur la pathogénèse de ces modifications, et particulièrement des ulcères gastroduodénaux, l'auteur met en évidence que la stase veineuse chronique, causée par «le cœur pulmonaire décompensé», en endommageant la vitalité de la muqueuse gastroduodénale, détraque l'équilibre acid-pepsine-résistance de la muqueuse gastroduodénale, qu'onque l'auteur souligne que cela n'est pas encore clair, ainsi le rôle des hypersecrétions surénales, que morphologiquement, se manifeste avec leur hypertrophie.

PARMIET E TRAJTIMIT TE THYERJEVE TE HAPURA DHE TE SHAKAKTUARA NGA ARMET E ZJARRIT NE KOKAT E KERCIKIT

— KSHM. LUVAN GREVA —

(Instituti Kërkimor i Mjekësisë Ushtrake)

Thyerjet e hapura të kockave të kërcirit, për numrin më të madh të demtimeve në krabasim me kockat e tjera të anësive (6, 9, 12, 17) e, për më tepër, për përqindjen e lartë të ndërlikimeve dhe pasojave mbeten problemi kryesor i trajtimit të thyerjeve të hapura në për-gjithësi (4, 6, 10, 21). Mjafton të përmendim që në luftërat pas Luftës II Botërore, thyerjet AZ të kërcirit zënë rreth 30% të thyerjeve të kockave të gjatave dhe në 55% të rasteve ndërlikohen me osteomielite (9, 10). Dihet se, për sa i përket patogjenezës, klinikës dhe ndërlikimeve, thyerjet e hapura kanë shumë ngjashmëri me ato me armë zjarri, kështu që edhe trajtimi i tyre është pothuajse i njëjtë. Ajo që i bën mik i kërcirit: kocka tibiale, veganerisht në 2/3-en e poshtme të saj, është më e vartë në garkullimin e gjakut në krabasim me të gjithë kockat e tjera të gjatave të anësive, sepse furnizimi me gjak i kësaj kocke bëhet vetëm nga një arterie ushqyëse kockore. Kështu që në thyerjet që ndodhin në 2/3-en e poshtme të tibies, sidomos në thyerjet me dy nivele, vartëria në furnizimin me gjak favorizon si mosngjithën e thyerjes, ashtu edhe infektimin e saj. Nga ana tjetër në 1/3-en e sipërtares së ashtu tibia është e drejtpërdrejtë me lëkurë, ku është edhe zona më e predispozuar për trauma, çka në thyerjet e hapura favorizon zhvillimin e infeksionit. Në raste defekti të lëkurës, që nuk janë të rralla, problem i vegantë mbetet mbullimi i kockës.

Pikërisht lidhur me këto vështirësi që paragjet thyerja e hapur dhe e shkaktuar nga armët e zjarrit në kockat e kërcirit, krabas të dhënave të literaturës, kolektivi i reparit të traumatologjisë të IKMU i ka kushtuar rëndësi të vegantë përcaktimit të parimeve bazë në trajtimin e ketyre demtimeve. Qëllimi i këtyr artikulli është paraqitja e përfundimeve të arritura në bazë të përvojës së eksperimentale dhe klinikë për njësimin e dhënies së ndihmës së kualifikuar dhe të specializuar në thyerje të tilla, kryesisht në ato të shkaktuar nga armët e zjarrit (1, 8, 9).

Në numrin I të vitit 1979 të këtij buletini kemi botuar studimin eksperimental mbi trajtimin e thyerjeve me armë zjarri të kërcirit (8). Për të arritur përfundime sa më të sakta, kryesisht për probleme të tilla të rëndësishme, sig janë mënyra e përpunimit kirurgjikal të plagës,

bioterapia patjetër të vazhdohet me antibiogramë. Në varësi nga rëndesa e traumës, antibiobiotikë duhet të vazhdojnë jo më pas se 10 ditë dhe jo më shumë se 20 ditë pas traumës. Rëndësi e veçantë u duhet dhënë antibiotikëve lokale, duke i injektuar në indet e buta rreth kanalit të plagës, mundësisht për 3-4 ditë e para (2, 7, 14, 16, 17).

2) Në qdo thyerje të tillë, pavarësisht nga shkalla e dëmtimit dhe e ndofjes së indeve, duhet të kryhet pastrimi mekanik dhe përpunimi kirurgjikal i plagës. Pastrimi mekanik e minimumizon shkallën e ndofjes mikrobiale. Këtë e kemi vërtetuar edhe në të dhënat e laboratorit (7, 9). Ky pastrim qëndron jo vetëm në pastrimin e sipërfaqshëm rreth plagës, por edhe në largjen e saj me treçësira të bollshme fiziolgjike dhe antiseptike, duke i futur këto me presion në thellësi të plagës.

3) Në thyerjet e hapura të grades III dhe ato të shkatuara nga armët e zjarrit në përgjithësi, është veshiturë të përcaktohet që ditën e parë indet e pajetë që duhet të hiqen (5, 10, 12). Prandaj në këto raste më i këshillueshëm është përpunimi kirurgjikal i etapizuar, pasi të jetë kryer pastrimi mekanik dhe përpunimi kirurgjikal i plagës, rreth kanalit të saj injektohet penicilina kristaline, zakonisht në doze 1 milion UI dhe vendoset fashaturë sterile. Anësia imobilizohet me logët allgje. Ndërkohë vazhdohet terapia me antibiotike. Të nesërmen ose të pasnesërmen i sëmurit dergohet përsëri në sallën e operacionit dhe, nën anestezinë e përshtatshme, bëhet përpunimi kirurgjikal i plotë i plagës. Po këtu vendoset përfundimisht mënyra e fiksimit të copëzave kockore.

Ne thyerjet e hapura të grades I dhe II, përpunimi kirurgjikal mund të quhet i përfunduar që në ditën e parë. Dëshirtojmë të theksojmë që përpunimi kirurgjikal i plagëve është kyç i trajtimit të thyerjeve kockore të hapura.

4) Si përpunimi mekanik, edhe ai kirurgjikal duhet të kryhet nën anestezinë të përshtatshme. Në thyerjet e hapura të kërçirrit, për mendimin tonë, më e këshillueshme është anestezia kockore, sepse, bashkë me anestetikun, futim në qarkullim venoz regional edhe antibiotikë. Kjo është një masë e mirë parandaluese e infeksionit, sepse në segmentin e anësistë nën zhguthin pneumatik futja e antibiotikut intrakockor krijon një përqëndrim të lartë të tij në gjak dhe ky përqëndrim mbetet më i lartë në anësinë përkatëse në krahasim me pjesët e tjera të trupit edhe për 24 orë pas heqjes së zhguthit (9, 12, 17). Përparesitë e anestezisë së përgjithshme janë të njohura, por në këtë e këshillojmë të përdoret më rrallë sot në kohë paqefjeje, duke pasur parasysh se në kushte lufte shpeshherë kirurgut do t'i duhet ta kryejë anestezinë vetë.

5) Palëvizshmëria e copëzave kockore është bazë në krijimin e kushteve të përshtatshme në procesin e shëritit të thyerjes. Sig vërehet në pasqyrën nr. 3, në thyerjet e hapura të kërçirrit në parapeqyem kryesisht imobilizimin me fashaturë allgje. Pra, si shumë autorë (2, 5, 10), jemi të mendimit që fashatura e allgjes të mbetet metoda kryesore në imobilizimin e thyerjeve të hapura të kërçirrit.

vendit që duhet të zëjë osteosinteza në këto dëmtime, lloji më i përshtatshëm i kesaj osteosinteze, vendimi për të mbyllur apo ja plagën, si dhe trajtimi me antibiotikë, jemi bazuar kryesisht në përvojën klinike të përtuar në 15 vjetet e fundit mbi thyerjet e hapura dhe AZ të kërçirrit. kemi marrë në studim 190 të aksidentuar me thyerje të hapura, të cilët përbejnë rreth 30% të të gjitha rasteve me thyerje të kërçirrit, të shtruar dhe të trajtuar në IKMËU nga 1969-1983. Pjesa dërrmuese e këtyre rasteve kanë pasur thyerje të dy kockave të kërçirrit. 6,84% (gjithsej 13 raste) kanë gënjë shokun dhe 5,9% (11 raste) kanë pasur edhe trauma të tjera shqetëse.

Për sa i përket lokalizimit dhe llojit të thyerjeve së kockës, në thyerjet e hapura mbizotërojnë ato të I/3-es së poshtme dhe të mesme dhe kryesisht janë thyerje me shumë copëza kockore (kominuete). Jo të rralla janë thyerjet në dy nivele. Në përqindje më të madhe dëmtimet kanë gënjë pasoja të aksidenteve rrugore, gjë që ka kushtëzuar edhe shkallën e dëmtimit në shumicën e tyre; sipas klasifikimit të pranuar nga ne (9), ato kanë gënjë të grades III dhe II. Nga 24 raste me thyerje nga armët e zjarrit, në 16 të dëmtuar plagosja është shkatuar nga plumbi, në 6 nga shpërthime dinamiti dhe në 2 raste nga armë gjahu.

Përfundimet e artitura në trajtimin e këtyre të dëmtuarve janë të aksidentuar kanë patur thyerje në të dy kërçirritë.

Inkurajuese dhe plotësisht të krahasueshme me ato që jepen nga autorë të tjerë (6, 10, 11, 13). Kështu, me pseudoartroze kanë përfunduar gjithsej 9,2% të rasteve, me osteomielit dhe pseudoartroze të injektuar 6,6% të rasteve. Është për t'u theksuar që atje ku është përdorur osteosinteza metalike përqindja e ndërlikimeve qëlbezuese ka gënjë më e madhe (9% kundrejt 4,2% të aksidentuarit e trajtuar në mënyrë ortopedike). Në raste të shëruara është vënë re që koha e konsolidimit të thyerjes është rreth 10 javë më e lartë se koha që duhet për t'u konsoliduar një thyerje e mbyllur kërçirrit, që, sig dihet, është 12 javë. Kemi vënë re që, në ato thyerje ku trajtimi ka gënjë ortopedik, konsolidimi të jetë artitur pas 22 javësh mesatarisht, ndërsa në raste me osteosinteze artitur ka gënjë më e shkurtër (20 javë) dhe në

osteosintezen dytësore 22,4 javë.

Në pasqyrën nr. 4 paraqitet puna e kryer në trajtimin e thyerjeve të hapura dhe atyre të shkatuara nga armët e zjarrit në kockat e kërçirrit.

Duke u bazuar në këtë veprimtari klinike 15-vjeçare, në eksperimentet e kryera dhe në përfundimet e artitura, kemi nxjerrë këto parime të jave për njësimin e trajtimit të thyerjeve të hapura dhe të shkatuara nga armët e zjarrit në kockat e kërçirrit:

1) Terapia me antibiotikë duhet të fillojë sa më parë, madje që në kontaktin e parë të aksidentuarit me entim shëndetësor. Fillojmisht mund të përdoret penicilina dhe streptomicina, por mandej anti-

LES PRINCIPES AU TRAITEMENT DES FRACTURES OUVERTES ET
DE L'ARME A FEU DE LA JAMBE

Résumé

Dans cet article on analyse 190 malades accidentés avec des fractures ouvertes et aussi de l'arme à feu de la jambe, traités pendant 15 années (1970-1984). L'auteur met en évidence les principes bases, qu'il faut les tenir compte pour faire l'union-fixation du traitement des ces lésions graves. L'auteur souligne particulièrement la nécessité de la désinfection mécanique, le traitement avec antibiotiques etc. En ce qui concerne l'ostéosynthèse primaire, l'auteur donne la primauté le fixateur antérieur, comme la méthode plus sûre, pour faire la guérison sans complications chez ces malades.

BIBLIOGRAFIA

- 1) *Batalii S. e bp.*: Aplikimi i osteosintezes metalike ne trajtimi e dëmtimeve të kombinuara në frakturat e hapura në katshë eksperimentale. Simpoziumi mbi frakturat e hapura. IKMU, 1975, 81.
- 2) *Boga P.*: Prociptet e mjekimit modern të frakturave. Shëndetësia popullore, 1965, 3, 38.
- 3) *Boga P. e bp.*: Drenimi aspirativ i plagëve operatore. Punime kirurgjikale, 1974, 4, 116.
- 4) *Boga P. e bp.*: Probleme të trajtimit kirurgjikal të osteomieliteve. Punime kirurgjikale, 1976, 1, 85.
- 5) *Boswick J.A. and coll.*: Principles of Treatment of Open Fractures. Early Care of the Injured Patient. 1976, 227.
- 6) *Decouls P.*: La Place de l'amputation dans les fractures ouvertes de jambe. Rev. chir. orthop. 1979, 11, 7.
- 7) *Duraku E.*: Flora bakteriale në frakturat e hapura. Simpozium mbi frakturat e hapura. IKMU, 1975, 36.
- 8) *Greva L.*: Trajtimi i frakturave me AZ të kërçitit në eksperiment. Buletini i UT-Seria shkencat mjekësore, 1979, 1, 95.
- 9) *Greva L.*: Trajtimi i frakturave të hapura të kockave të gjata të anësive. Disertacion, 1980.
- 10) *Gustilo R.B. e bp.*: Prevention of Infection in the Treatment of the Open Fractures of Long Bones. J. Bone a. Joint Surg. 1976, 4, 453.
- 11) *Karapajza P.*: Pseudoartrrozat. Tirane, 1984, 97.
- 12) *Karapajza S.G. e bp.*: Taktika hirurgjikeskogo legenija oqnestrejljnih perelomov tubagjn kostej, ortop. travm. protez. 1984, 6, 11.
- 13) *Leceste e bp.*: Fractures ouvertes de jambe. Indications et résultats. Rev. Chir. orthop. 1979, 11, 70.
- 14) *Patzakis M.S. and coll.*: The Role of Antibiotics in the Management of Open Fractures. J. Bone a. Joint Surg. 1974, 4, 532.
- 15) *Riska B.B. and coll.*: Primary Operative Fixation of Long Bone Fracturs in Patients with me Hiple Injures. J. Trauma, 1977, 17, 111.
- 16) *Trubnikov V.F. e bp.*: Legenie perelomov dljnih trubgstin kostej i postra-datshin s smozhestvenimi i soqetannimi povrezhdenija ni. Ortop. trav. i protoz. 1983, 4, 28.
- 17) *Xoxa P. e bp.*: Probleme të trajtimit të thyerjeve të hapura të kockave të gjata të anësive. Shëndetësia popullore, 1978, 2, 41.

PERDORIMI I MASAZHIT ME GISHTA PËR ULJEN E TENSIONIT INTRAOKULAR NË OPERACIONIN E FERDES

— BASRI NEZIRI —

(Spitali i rrethit — Peshkopi)

Për operacionin e heqjes së perdes, rëndësi të vegantë ka ulja e tensionit të brendshëm të syrit (tensionit intraokular — TO) para hapjes së syrit. Me hapjen e syrit, TO bazohet me presionin atmosferik, por, kur TO ka geneë i ulët, para hapjes së syrit diastagma irido-kristaliniane ka prirje të bjerë prapa, gjë që krijon kushte ideale për heqjen e perdes. Gjithashtu, ndërlëkimi më i rëndësishëm paraoperatorë, që ndikojnë shumë në rezultatat e afërta dhe të largëta të operacionit të perdes, është humbja e trupit qëllor gjatë operacionit, ndërlëkimi që ulët shumë kur operohet në sy të butë (me TO të ulët). Për të ulur TO, veg masave të tjera, përdoret edhe ushtrimi i një shtypjeje të lehtë dhe të vazhdueshme mbi syrin e mbyllur, e cila bëhet me aparate të veganta (okulopresore) ose masazhi me dy gishta. Masazhi me gishta bëhet pasi syrit i është bërë akinezia dhe anestezia retrobulbare. Kjo procedurë përdoret gjërësisht në vendin tonë, por qëllimi i studimit tonë është që të përcaktojmë sa është praktikisht ulja e TO me masazhin me gishta, sa kohë zgjat kjo ulje dhe gjatë pasojash ose ndërlikimesh të mundshme mund të vijnë prej tij.

MATERIALI DHE METODIKA

Janë marrë në studim 61 të sëmurë (100 sy) me moshë nga 14-83 vjeç (mesatarisht 38,08 vjeç) — 37 meshkuj dhe 24 femra. Këta të sëmurë kanë vuajtur nga perda ose nga sëmundje të tjera të syrit, që nuk ndikojnë në ngritjen ose uljen e TO dhe që kornenë e kishin të padëmtuar. Për çdo sy janë bërë 5 matje me tonometrin e aplana-cionit Maklakov me peshë 10 gram. matja e parë është bërë para masazhit, e dyta menjëherë pas masazhit, e treta 2 minuta pas masazhit, e katërta 5 minuta pas masazhit dhe e pesta 10 minuta pas masazhit. Masazhi është bërë me gishtat tregues të duarve, të vendosur mbi kapakun e sipërm të syrit dhe duke shtypur kokërdhokun jo me shumë forcë (njëlloj si kur matet TO me gishtat), masazhi ka zgjatur 3 minuta për çdo sy, koha për masazhin dhe matjen e TO është matur me kronometër. Është bërë masazhi me gishta edhe në 10 të sëmurë (10 sy) glaukomaatozë. Për masazhit të sëmurët nuk kanë marrë asnjë lloj mjekimi që ndikojnë ose jo në TO.

REZULTAET

TO para masazhit është lekundur nga 16-23 mmHg, mesatarisht 19.34±1.74 mm Hg. TO menjëherë pas masazhit është lekundur nga 12-21 mmHg, mesatarisht 14.54±2.07 mm Hg dhe TO 10 minuta pas masazhit është 1 lekundur nga 12-22 mmHg, mesatarisht 15.46±2.02 mm Hg. TO pas 2 dhe 5 minutash ka gene mesatarisht 14.82 dhe 15.16 mmHg, përkatësisht TO mesatar pas masazhit në krahësim me atë para masazhit është 4.8 mmHg më i ulët dhe pas 10 minutash ai është rritur vetëm 0.92 mm Hg. TO më i shpeshtë (moda statistikore) para masazhit ka gene 19 mm Hg, menjëherë pas masazhit 14 mm Hg dhe pas 10 minutash 15 mm Hg.

Në 31 të sëmurë me moshë nën 30 vjeç (53 sy) TO mesatar para masazhit ka gene 18.89 mmHg, pas masazhit 14.82 mmHg, me diferencë 4.07 mmHg. Në 10 sytë glaukوماتoze TO është ulur pas masazhit vetëm 1.2 mmHg.

Pas masazhit në të gjithë sytë është vërejtur hipereimi jo e theksuar e konjuktivës dhe episklerës. Të gjithë të sëmurët nuk kanë pasur asnjë shqetësim, veç turbullimit të përkohshëm të të parit nga ngjyra kafe me të cilën lyhet tomometri.

DISKUTIM

Për uljen e TO para operacionit të perdes, përdoren lëndët osmotike (manitol intravenoz, glicerinë intravenoze ose nga goja e.)⁽¹⁾ ngjitja e kokës së të sëmurit lart (në pozicionin anti-Tredelnhurg), trenuesit e ajo e përgjithshme, vitrektomia në *pars plana* në trupit ciliar, si edhe ushtrimi i shlypjes së lehtë dhe të vazhdueshme të syrit të mbyllur me oklupresor ose me gishta. Mekanizmi i uljes së TO i këtyre procedurave është dhënë në figurë.

Në i kemi përdorur të sëmurët tanë të operuar shumicën e këtyre procedurave, me përjashtim të sklerotomisë në *pars plana*, e cila përdoret tek të sëmurët që kanë katarakt në të njëjtën sy dhe kur TO nuk ulët me procedurat e tjera që përmendëm më sipër, por që në nuk kemi pasur rast ta përdorim as për këta të sëmurë.

Masazhi me gishta për uljen e TO para operacionit të perdes është kënaqësive për përdorin si njëzën metode, ashtu edhe tjetren (6,8). Mekanizmi i uljes së TO nga masazhi dhe oklupresioni është i njëjtë. Masazhi me gishta sjell zvogëlimin e vëllimit dhe të peshës së trupit qëllor. Nga studimet eksperimentale në katshë, ulja në peshë e trupit qëllor vjen nga humbja e ujit prej tij, por ndoshta ndihmojnë edhe faktorë të tjerë, si acidi hialuronik dhe jonet (8), ndërsa autorë të tjerë mendojnë se humbja e ujit nuk ndodh vetëm në trupin qëllor, por dhe në indin orbital (6).

Pas masazhit me gishta, TO është ulur në të sëmurët tanë nga 2-10 mmHg (mesatarisht 4.8 mmHg) dhe ka gene mesatarisht 14.54±

± 2.07 mmHg, vegse në ta nuk është përdorur asnjë medikament ose procedurë tjetër hipotonizante. Duke shtuar edhe efektin e procedurave të tjera hipotonizante, TO ulët akoma më shumë dhe krijohej kushte optimale për të operuar në sy të butë. Ka autorë që gjëjnë ulje më të theksuara të TO, por me presion 40 mmHg për 10 minuta TO është matur me tonometër apnacioni Goldman (8), ndërsa autorë të tjerë gjëjnë nganjëherë ulje të theksuara të TO nga masazhi me gisht me kolaps të sklerës (4). Ujje më të theksuara se 10 mmHg në nuk kemi gjetur në asnjë rast. Në pak raste TO ka gene nën 12 mmHg (në e kemi konsideruar 12 mmHg), por tonometri që kemi përdorur nuk mat nën 12 mm Hg me peshë 10 gr, ndërsa në këta të sëmurë matja me peshën 7.5 gr nuk ka gene në asnjë rast nën 10 mmHg.

Për disa autorë, ulja e TO pas masazhit varet nga moshë. Në moshat e reja, meqenëse trupi qëllor përmban më pak ujë, ulja e TO pas masazhit është më e vogël, ndërsa në femijët ajo është e parëndësishme (6); kurse ka të tjerë që nuk gjëjnë dallim të uljes së TO pas masazhit nga moshë (8). Në materialin tonë, 31 të sëmurë kanë gene nën 30 vjeç. Tek këta të sëmurë ulja e TO pas masazhit ka gene 4.07 mmHg, d.m.th. 0.73 mmHg më e vogël se mesatarja e përgjithshme dhe 1.12 mmHg më e vogël se mesatarja e të sëmurëve me moshë mbi 30 vjeç. Masazhin me gishta mund të përdoret me rezultat edhe në moshat e reja.

Dihet se masazhi me gishta nuk ka efekt në sytë glaukوماتoze dhe në rastet tona (10 sy) ulja pas masazhit që e parëndësishme — vetëm 1.2 mmHg.

Për disa autorë, masazhi me gishta dhe me oklupresioni mund të shkaktojë dizavantazhe dhe ndërlikime, si hipereimi të konjuktivës dhe episklerës me prirje për hemorragji gjatë presjes, hipotoni të theksuar me veshtrësime në kryerjen e disa manipulacioneve (4), deri në ndërlikime të rënda me rritje dytësore të TO me derdhje kortikoidale e humbje vitrosi (5), ndërsa për të tjerë procedura është pa ndërlikime (1,2,3,4,6,10). Gjatë studimit kemi vërejtur hipereimi jo të theksuar të konjuktivës dhe episklerës, nuk kemi lidhur me masazhin asnjë ndërlikim preoperator. Për të mënjannuar uljen e theksuar të TO nga masazhi, shtypja me gisht mbi sy nuk duhet të bëhet me forcë, pasi ulja e TO është në përpjestim të drejtë me forcën e ushtruar mbi sy dhe kohën e zgjatjes së procedurës shtypëse.

Dorëzuar në redaksi më 19.3.1985

ainsi que l'élaboration statistique des données. Il résulte, après le massage, une baisse de 2 à 10 mmHg de la pression intraoculaire (la moyenne 4,8 mmHg). Dix minutes après le massage, la pression reste toujours basse (remarquable une hausse seulement de 0,92 mmHg). La baisse de la pression intraoculaire a été constatée aussi chez les malades âgés de moins de 30 ans. Le massage n'a quasi pas influencé la pression intraoculaire chez les patients avec glaucome. On n'a pas constaté d'importantes complications oculaires après le massage. L'auteur compare les résultats obtenus avec ceux des autres auteurs albanais et étrangers.

Le massage digital est un procédé simple, mais efficace, qui peut être employé avant l'opération dans tous les services d'ophtalmologies.

KARCINOMA BRONKIALE DHE FIBROSKOPIA NE DIAGNOSTIKIMIN E SAJ

— ALBERT SOTRI —

(Instituti i Fiziko-pneumologjise)

Në kohën e sotme, karcinoma bronkiale përben një nga patologjitë kryesore në pneumologji. Dënduria e rasteve me kancer të mushkërtive është rritur shumë në këto dekadat e fundit, dhe, sipas të dhënave të OBSH-se, çdo vit ajo ka një rritje prej 5 deri 6%. Në institutin tonë, për vitin 1983 ajo përfshinte 24,3% të të gjithë të shtruarve në pneumologji. Për këtë arsye, diagnostikimi i shpejtë i saj ka lidhje të drejtpërdrejte me efektshmërinë e mjekimit dhe me uljen e dëgëndrimit të të sëmurëve në Institut.

Në këtë drejtim, një ndihmesë të rëndësishme ka dhënë ekzaminimi bronkologjik i kryer në kabinetin e bronkologjisë të këtij instituti. Endoskopia bronkiale bën pjesë në bilancin pneumologjik menjëherë pas klinikës dhe radiologjisë. Deri në vitin 1982, ekzaminimet bronkoskopike janë kryer me bronkoskop rigid tip Storz, kurse në vitin 1983, me pajisjen fibroskopike, endoskopike, u kryen me bronkofibroskop tip Olympus BF B3R.

Sot kudo në botë është përhapur përdorimi i fibroskopisë dhe indikatorit e tij janë rritur në mënyrë të ndjeshme. Një autor (9), në monografinë e tij «Fibrobronkoskopia dhe zbatimet e saj klinike», pohon se «metodika fibroskopike ka gënë fitorja në e madhe pneumologjike e diagnostikimi i hershëm i së cilës ka rëndësi të madhe në mjekimin e saj, si edhe në rezultatet pozitive të këtij mjekimi. Indikatorionet klinike të një fibroskopie për diagnostikimin onkologjik mushkërtor mund t'i përmbledhim në këtë mënyrë:

1. Kur ka të dhëna kliniko-radiologjike për tumor trakeo-bronkial.
 2. Në mungesë të kuadrut kliniko-radiologjik, pranua në sputum e gëllzave atipike për tumor trakeo-bronkial.
 3. Hemoptizi e një natyre të papercaktuar.
 4. Kollë kronike e një natyre të papercaktuar.
 5. Dëmtime të dysshimita për proces neoplazik.
- Gjatë një ekzaminimi fibroskopik për diagnostikimin e karcinomës bronkiale, janë të nevojshme këto elemente:
- Gjetja e shenjave endoskopike të drejtpërdrejta apo të tërthorta të karcinomës bronkiale.

Tabela 112

DI NUK PI	FEMRA	QYTET	TSHHT	DUHAN DUHAN
Nr	165	12	106	71
%	93	6,7	59,8	40,1
				94,2
				5,8

Sipas shenjave klinike, simptoma kryesore që e detyron të sëmurin të vizitohet është kollja, të cilën në kemi takuar në 49% të rasteve (Tabela nr. 3), si edhe dhembjet e gjoksit (37,8% e rasteve). Por simptoma më alarmante, që e detyron të sëmurin të drejtohet mjekut, është hemoptizia, të cilën në kemi takuar në 18% të rasteve. Pra, kollja, dhembjet e gjoksit dhe hemoptizia janë tri shenjat kryesore, që në moshë të avancuar dhe tek ata që përdorin duhan të bëjnë të dyshosh për praninë e një karcinome bronkiale.

SIMTOMAT E FILLIMIT TE CA

Tabela 3

Nr. Rënd.	SIMTOMAT	Numri	Përqindje
1-	Kollja	87	49
2-	Dhembje gjoksi	67	37,8
3-	Hemoptizoe	32	18
4-	Disyneza	22	12,4
5	Sindrom artikular	12	6,7
6-	Sindrom pulmonar	17	9,6
7-	Sindrom nervor	3	1,6
8-	Sindrom kokëftik	5	2,8

Dihet se kanceri i mushkërive prek moshat mbi 40 vjeç, dhe kryesisht moshat mbi 50-70 vjeç. Në materialin tonë këto moshë përbejnë gati 70% të të gjitha rasteve tona. (Tabela nr. 1). Megjithatë takohen raste me kancer edhe nën moshën 40 vjeç, që në materialin tonë përbejnë 3,3%. Nga 177 raste, meshkuj janë 93,2% dhe femra 6,7%, d.m.th. raporti meshkuj-femra është 14:1. Autorë të ndryshëm japin raporte të ndryshme, që shkojnë nga 4 deri 32:1. E dhëna jonë përputhet pak a shumë me ato të autorëve tanë (7). Sipas vendbanimeve, raste me kancer i kemi takuar më shumë në qytetarët (59,8%), se sa në fshatarët (40,1%) (Tabela nr. 2). Sipas shumës së autorëve (5,7,8), abuzimi në pirjen e duhanit shihet si faktor kryesor i mundshëm në etiologjinë e kancerit të mushkërive. Në materialin tonë 94,2% e pini duhanin, kurse 5,8% jo.

Dihet se kanceri i mushkërive prek moshat mbi 40 vjeç, dhe kryesisht moshat mbi 50-70 vjeç. Në materialin tonë këto moshë përbejnë gati 70% të të gjitha rasteve tona. (Tabela nr. 1). Megjithatë takohen raste me kancer edhe nën moshën 40 vjeç, që në materialin tonë përbejnë 3,3%. Nga 177 raste, meshkuj janë 93,2% dhe femra 6,7%, d.m.th. raporti meshkuj-femra është 14:1. Autorë të ndryshëm japin raporte të ndryshme, që shkojnë nga 4 deri 32:1. E dhëna jonë përputhet pak a shumë me ato të autorëve tanë (7). Sipas vendbanimeve, raste me kancer i kemi takuar më shumë në qytetarët (59,8%), se sa në fshatarët (40,1%) (Tabela nr. 2). Sipas shumës së autorëve (5,7,8), abuzimi në pirjen e duhanit shihet si faktor kryesor i mundshëm në etiologjinë e kancerit të mushkërive. Në materialin tonë 94,2% e pini duhanin, kurse 5,8% jo.

Tipizimi cito-histologjik i procesit neoplazik.
 — Përaktimi i shtrijës endoskopike të patologjisë, si edhe zbulimi i prekjes së strukturave të afërta (si gjëndrrat limfatike peritrateo-bronkiale, mediastinale, etj.). Kjo është e nevojshme për të saktësuar stadin e sëmundjes (sipas sistemit ENM) dhe për të përcaktuar trajtimin e mëvonshëm kirurgjikal.
 Në semilogjinë endoskopike të karcinomes bronkiale, një autor (cituar nga 3) bën këtë ndarje: shenja të drejtpërdrejta, shenja të tërthorta, asnjë shenjë.
 Kazuistika jonë përbehet prej 177 rastesh me karcinome bronkiale, të vërtetuar me ekzamimin histologjik, të cilave u është bërë bronkoskopia. Te gjithë rastejt janë për vitin 1983.

SHPERNDARJA SIPAS GRUP-MOSHAVE

Tabela 1

Nr. Rënd.	M O S H A (v j e ç)	Nr. RASTEVE	%
1-	Nën 40	6	3,3
2-	41-50	30	16,9
3-	51-60	60	33,9
4-	61-70	63	35,5
5-	Mbi 70	18	10
6	Shuma	177	100

123 = 69,5%

Një nga problemet më të rëndësishme është diagnostikimi i hershëm i kancerit bronkial. Por kjo është sa e domosdoshme, aq edhe e vështirë për t'u realizuar, sepse lidhet me një sërë problemesh dhe hallkash të ndërmytme. Kështu, në materialin tonë 45.7% e rasteve paraqiten tek ne me diagnozën hije mushkëriore për t'u përcaktuar, 31.6% me diagnozën e dyshimi, por atëherë është vonë mundja fillon të përparojë, lind edhe dyshimi, por atëherë është vonë për mjekim. Nga të sëmurët e ekzamnuar, 60% vijnë 1-3 muaj pasi kanë filluar shfaqjet e shenjave klinike. Lidhur me këtë, jemi munduar të bëjmë një ndarje të sëmurëve në stadi, sipas klasifikimit TNM të dhënë nga OBSH-ja. Ky klasifikim mbështet kryesisht në të dhënat e bronkoskopisë. Nga materiali ynë, rezultojnë: në stadin e parë 40.6% e të sëmurëve, në stadin e dytë 50% dhe në stadin e tretë 54.1%. Pra, del se shumica e të sëmurëve të diagnostikuar nga ne paraqiten në stadi të vonshme të sëmundjes, kur ata janë të paoperueshëm. Megjithatë mund të themi se, me gjithë përpjekjet e shumta që mund të bëhen për diagnozën e hershme të kancerit të mushkërive, ky është një problem sa i gjërë, aq edhe i ndërlikuar, ku përkëmben një sërë faktorësh të ndërmyshëm, dhe ku diagnoza e hershme e kancerit bronkial mund të bëhet «në stadin para shfaqjes mushkëriore të tij» (8).

Në këtë drejtim një ndihmë të madhe jep ekzamini fibroskopik, i cili krijon mundësi për përcaktimin e tumorit, lokalizimin, infiltrimin e organeve fqinje, shtypjet nga adenopatitë e tij, jo vetëm nëpërmjet të dhënave makroskopike, por edhe nëpërmjet marrjeve të ndryshme cito-histologjike, që përcaktojnë tipin histologjik të karcinomës. Kjo ndihmon në përcaktimin e metodës së mjekimit. Nga të dhënat tona, me shenja të drejtpërdrejta rezultojnë 85.3% e rasteve. Pjesa tjetër ka pasur shenja të tërthorta ose funksionale (Tabela nr. 4). Lokalizimi i karcinomës është më tepër në të djathtë (105 raste), se sa në të majtë (72 raste), dhe më shumë në lobet e sipërme, se sa në ato të poshtme (për të gjitha shih tabelën nr. 5). Në e kemi të detyrues të lokalizuar në bronket segmentare të djathta në 7 raste (nga këto, një në subsegmentin të përparmë të segmentit të tretë), ndërsa në të majtë në 11 raste të lokalizuara në bronket segmentare të lobit të sipërm të majtë. Kjo dëshmon për rritjen e efektshmërisë së fibroskopisë në diagnozën e karcinomës së lokalizuar në degëzimet bronkiale më periferike.

Kështu, me një bashkëpunim dhe lidhje të ngushtë të klinicistëve e radiologëve, bronkologëve e kirurgëve, mund të ndihmojmë sado pak në mjekimin e kesaj sëmundjeje të rëndë.

Nga sa thamë më sipër, dalin këto përfundime:

1) Në Institutin tonë, karcinoma bronkiale përben sot një nga patologjitë kryesore, diagnostikimi i hershëm i së cilës ka rëndësi të madhe për efektshmërinë e mjekimit të saj.

2) Në kohën e sotme, fibroskopija është një metode e thjeshtë dhe shumë e domosdoshme për ekzaminiimin e sëmundjeve të mushkërive, sidomos për ekzaminiimin e karcinomës bronkiale.


SHENJAT MAKROSKOPIKE

DIREKT		INDIREKT				
1	TUMOR	95	53.6%			
2	INFILTRIM	58	32.76%			
1-	Stenoze	15				
2-	Komprimim	10				
3-	Hemoragji	4				
4-	Rigiditet	4				
5-	Zgjerimi i korinave	17				

Tabela 4

SKEMA E LOKALIZIMIT BRONKIAL

Tabela 5



REZULTATET E BIOPSISE BRONKIALE

Nr. Rendi	TIPË HISTOLOGJIK	Numeri Rendi	Numeri Rendi
1-	Adenokarcinome	4	3.7
2-	Epidermoid	25	23
3-	Mikrocelular	20	18.5
4-	Dyshimfo	15	13
5-	Adenome	1	0.9
6-	Negativ	43	39.8

Tabela 6

65 = 60% }
43 = 39.8% }

REZULTATET E LAVAZHEVE BRONKIALE

Nr. Rendi	TIPË HISTOLOGJIK	Numeri Rendi	Numeri Rendi
1-	Adenokarcinome	1	1
2-	Epidermoid	1	1
3-	Mikrocelular	-	-
4-	Dyshimfo	20	20.4
5-	Adenome	-	-
6-	Negativ	76	77.5

Tabela 7

22 = 22.5% }

76 = 77.5% }

3) Për të ndihmuar në diagnostikimin e hershëm dhe mjekimin e saj kirurgjikal me sa më shumë efektshmëri, është e nevojshme që t'i nënshtrohen ekzaminimit fibroskopik:

a) gdo i sëmurë mbi moshën 40 vjeç, që paraget një kollë të thatë ngacmuese, të pazotërvëshme nga mjekimet e dhëna, pa ndonjë të dhënë të rëndësishme kliniko-radiologjike;

b) rastet me hemoptizi të pashpjegueshme nga të dhënat kliniko-radiologjike;

c) pneumopatie e përsëritura në kohë të shkurtër ose që ngulmojnë pavarësisht nga mjekimi.

Dorëzuar në redaksi më 19.8.1984

BIBLIOGRAFIA

1. Anthoine D., Carnet B., Vincent M.A.: Le Lavage broncho-alvéolaire, nouvelle technique d'investigation en pneumologie. Médecine, 1980, 3, 150-155.
2. Bombi C., Capechi V., Cavalli F., Falcone F., Falasano E.: La cinematografia della fibrobroncoscopia ecc. Riv. pat. clin. tuberc. e pneumol, 1982, 53, 141-156.
3. Falcone F., Fasano E., Ferretti A., Minore G.C., Vincenzi M.: La fibrobroncoscopia nella diagnostica del carcinoma bronchiale. Riv. pat. clin. tuberc. e pneumol, 1982, 53, 157-182.
4. Lamaze R., Anthoine D., Lamy P.: Les Traitements du cancer bronchique, strategie actuelle. Médecine interne, 1980, 3, 186-196.
5. Lamy P., Anthoine D., Lamaze R.: Bronchoscopie au fibroscope bronchique? Comparaisons et indications en 1980.
6. Lukomski G.I.: Bronkologija. Medicina — Moskva, 1973.
7. Pepivani P., Sotiri A.: Bronkoskopia në kancerin bronko-pulmonar Shëndetësisë popullore, 3, 1975, 14.
8. Preza K.: Rëntgendiagnostika e kancerit të mushkërive. Tiranë, 1978.
9. Valenti S. te coll.: La fibro-broncoscopia e le sue applicazioni cliniche. Ed. Minerva medica, Torino 1980, 4.

Summary

BRONCHIAL CARCINOMA AND THE USE OF FIBROBRONCHOSCOPY FOR ITS DIAGNOSIS

Bronchial carcinoma is described as one of the most important pathologies at present in pneumology. The study comprises 177 cases of bronchial carcinoma diagnosed by fibrobronchoscopy and confirmed by histopathologic examinations. All the cases were observed in 1983.

After the main clinical signs, the paper describes in detail the fibroscopic findings as the basic element in the diagnosis of the disease. This examination permits not only to directly visualize the lesions, but also to obtain samples for their histologic identification.

PROSTATIEKTOMIA TRANSVEZIKALE

(Sipas Denis — modifikuar me depression të llozës)

— KASTRIOT DAVTAJ —

(Spitali Klinik nr. 2 — Tiranë)

Prostatiektomia transvezikale sot për sot, edhe me përparimin e kirurgjisë endoskopike, mbetet një nga teknikat baze, sidomos në pro-
state të mëdha dhe pikësepari në pozicionin endovezikal, me ngritje të
fundit uretral në formën e grepit të peshkut.

Pas gdo prostatektomie me vezikë të hapur mbetet një sasi e
ndjeshme me stazë vezikale, e përberë nga urina dhe gjaku, e përzier
me glukozën e infuzioneve intravenoze, të cilat, sig dihet, eliminohen me
anën e urines.

GJËLLIMI I STUDIUMIT

Pas gdo prostatektomie me vezikë të hapur lindin probleme të përu-
dhes pas operacionit që nganjëherë zgjidhen me veshtrësi, dhe shpesh
behën edhe burim ndërlikimi me pasoja për të semurin. Edhe në mate-
rialin që paraqitim në këtë punim, duke pasur parasysh këto ndërlikime
dhe të mbështetur në literaturën bashkëkohore, vumë në praktikë këtë
metodë të re operacioni, me të cilën patëm rezultate premtuese dhe që
mund të vihen në zbatim nga kirurgjë të tjerë urologë, pa kërkuar
shumë pajisje speciale. Kjo metodë operacioni bën një modelim të mirë
të gatës së vezikës urinare, gjë që i siguron të semurit një ecuri të lar-
gët të favorshme.

Në zbatimin e kësaj metode kemi pasur gjithmonë për qëllime të
mbajmë një vezikë urinare vazhdimisht të thatë, pasi në këto kushte
ajo rigjenerohet më mirë. Gjithashtu dihet se hemostaza e mirë dhe
të urokinezës mbi plazmogjienin dhe transformimin e tij në plazmë,
mbajtja e një vezike urinare të thatë pakëson mundësinë e veprimt
substançë që ka aftësi të shkatërrojë trombet që rrethojnë vazat e prera,
të gjakut. Kur hemorragjia është e madhe, rreziku rritet jo vetëm
nga fakti i sasisë së madhe të gjakut të humbur, por edhe se koagulat
bllokojnë sondat e drenazhit, gjka bën të domosdoshëm lavazhin me
previon, që është i aftë të shkatërrojë nokullimin e infeksionit në qar-
kullimin e gjakut (2).

Kallimi i lengut të lavazhit nëpërmjet vezikës urinare tani më është
provar me ndihmën e izotopeve. Po këta autorë (2) kanë provuar se
materiali i mbetur pranë shtratit të të semurit infektohet me një shpej-

CARCINOME DES BRONCHES ET LE RÔLE DE LA FIBRONCHOSCOPIE
DANS SON DIAGNOSTIC

Résumé

La carcinome des bronches est actuellement une des plus importantes patho-
logies en pneumologie. L'étude comprend 177 cas atteints de carcinome des bron-
ches diagnostiquée par la fibronchoscopie et confirmée par les examens histo-
pathologiques. Tous les malades ont été observés pendant l'année 1983.

Après avoir présentée les principaux signes cliniques, dans l'article l'auteur
décrit en détail les données de la fibroscopie comme un examen fondamental dans
le diagnostic de la maladie. Cet examen non seulement permet une directe visua-
lisation des lésions, mais aussi, par des prélèvements, détermine le type histologique.

Prandaj pas prostatëktomisë lind si nevojë e ngutshme zbrëzja nga korganat e vezikës urinare dhe dhënia e gjakut të freskët. Këtë formë punë kemi përdorur edhe në të sëmurët tanë. Autorët të tjerë ngulin këmbë për hemofilinë B latente. Si ndërlikim rezulton stenozë e llozës. Të gjitha metodat e prostatëktomisë mund të japin stenozë të gatës, që janë: sklerozë dhe diatragma nukozë.

Pra, prostatëktomia me depresion nuk jep më shumë se metodat e tjera stenozë dhe as më pak inkoninencë. Nga të gjithë të sëmurët tanë, që kemi marrë në studim, ne kemi pasur vetëm një rast me strukturë urëtrë pas operacionit, që u korrigjua pas dy javësh me uretrotomi.

MATERIALI DHE METODA

Kemi marrë në studim 24 të sëmurët, të shtruar dhe të kuruar në klinikën nr. 2 gjatë vitit 1984. Moshë mesatare e të sëmurëve ka qenë 60 vjeç. 16 nga këta të sëmurë janë shtruar si urgjencë. Prej këtyre, 12 ishin kateterizuar, ndërsa 4 të sëmurë u drenuan para-praktisht me punkcion suprapubik dhe redom.

Nga ekzaminimet paraprake të të sëmurëve, 10 nga këta rezultuan me ndryshime kardiale. Nga këta, 4 u kuruan për një kohë para operacionit, ndërsa 6 të tjerët kishin ndryshime të vjetra iskemike dhe nuk kishin nevojë për trajtim të vegantë. Në ekzaminimet pëlografike, vetëm 4 nga këta kishin zgjerim të rrugëve të sipërme urinare, që u stabilizua pas derivacionit paraprak të urinës për disa ditë para operacionit.

Si teknike operatore të të gjithë të sëmurët u procedua sipas Denis-it, por në vend të fizes të patitshëm u përdorën dy gjysma ser-klazhi të thithshëm dhe në vend të kateterit uretral me redom thithës (një trup i vetëm) u modifikua me redom transuretral 9 *charie* të vegantë. Gjithashtu, megjithëse Denis-i nuk vendos sutura hemostatike, në të sëmurët tanë, për të vendosur një hemostatikë intraoperatore më të mirë, ne vendosëm sutura hemostatike në orën 5 dhe 7. Si drenazh plotësues, u përdor tub polietileni traspartetral anësor. Në të gjithë të sëmurët, kateteri u hoq ditën e 9-10-të, ndërsa tubi i polietilenit u hoq në ditën e 11-të. Ecuria intraoperatore dhe pasoperatore e menjëherëshme ka qenë e mirë, nuk kemi pasur asnjë fistul, suprapubike. Të gjithë të sëmurët, kontrolli 6 muaj pas operacionit ka rezultuar pa asnjë stenozë të gatës urëtrale. Vetëm në një rast pasëm veshtrësi në nxjerrjen e kateterit ditën e 11-të. Tëk ai u verëjtën grrëgjillime të urinimit me distancë dhe hollim të gurtut urinar. Në urografat dukëj një strukturë e urëtrës, e cila u buzhua, ndërsa gata e vezikës urinare dhe lozha prostatike ishtë e formuar plotësisht. I sëmurit nuk pati nevojë për përpunim kirurgjikal të mëtejshëm.

KONKLuzion

Prostatëktomia transvezikale mbetet ende një metodë kirurgjikale me rëndësi për kurimin e adenomës së prostatës. Në përpunimin e llozës prostatike, të gjitha modifikimet qëndrojnë në pakësimin e hemo-

TEKNIKA

tësi të jashtëzakonshme. Dy orë pas fillimit të lavazhit janë gjetur 3000 mikrobo në 1cm dhe 350000 pas 5 orëve.

Gjithashtu, dihet se një shkak me rëndësi i shokut endotoksik është infeksioni uretral, që përben 70-90%. Të gjithë këtë, autorë të ndryshëm e kanë përmbledhur me një frazë: «Shumë të sëmurë të vdesin nga kateteri uretral, po aq sa është edhe prostatëktomia» (1).

Duke u nisur nga këto parime, në vitin 1964 ne thithëm përmbajtjen vezike të llozës prostatike me ndihmën e një rendomi thithës.

Serklazhi submukoz i llozës prostatike me ketgut nr. 1; duke mbyllur orificiumin e sipërm të llozës, që i takon vendit të ostiumit të brendshëm të urëtrës, mbi një sondë që zbrës vezikën dhe të një rendomi uretral, siguron zbrëzjen e gjakut nga llozha prostatike. Depresioni që krijohet në llozën e mbyllur siguron një hemostazë më të mirë, duke kolabuar parëtrë e llozës. Po ashtu, ndarja e gjakut nga përmbajtja urine e vezikës siguron një ecuri më të mirë të operacionit. Të gjitha teknikat e ndryshme operatore kanë pasur e kanë për qëllim të sigurojnë një hemostazë të mirë dhe një drenazh vezikal të plotë (3).

Modifikimi i kësaj metode qëndron në vendosjen e sutureve gjysmë-rrethore të thithshme, në vend të një suture të patitshme, të fiksuara nga jashtë gatës së vezikës urinare, që e heq ditën e 10-të. Kjo metodë ka të metën e madhe se mund të lejojë kallimin e infeksionit në *spatium Reyc* nëpërmjet fijeve të patitshme. Prandaj duhet pasur kujdes që suturet të vendosën submukoz për të menjanuar diatragmën mukozë. Gjithashtu, për të pakësuar sa të jetë e mundur hemorragjinë, mund të futim noradrenalinë submukozë.

Për të mbyllur në mënyrë sa më hermetike hapjen vezikale të llozës, para se të tërheqim kateterin në vezikë, i shtrëngojmë suturet me anën e një sete të lidhur në mëtej të tij. Kështu është proceduar me të sëmurët që po paragjithim në këtë punim.

Zakonisht redomi thithës, i vendosur në llozën prostatike, hiqet ditën e dytë apo të tretë, ndërsa kateteri hiqet ditën e 9-të. Ndërsa, në të sëmurët tanë, tubi polietilen u hoq ditën e 11-të.

Për sa i përket hemorragjisë nëpërmjet kirurgjisë tjetër dhe kirurgjisë prostatike, ka një ndryshim. Në të parën, hemorragjia pakësohet sa më shumë i afrohem fundit të operacionit, ndërsa në hemorragjinë prostatike ajo fillon në fund të operacionit, ose 2-3 orë pas mbartimit të operacionit. Prandaj ka rëndësi të madhe sigurtimi i një hemostaze të mirë intraoperatore dhe i një zbrëzjeje të mirë të vezikës urinare. Kjo ka bërë që të gjithë urologët të këmbëngulin në përpunimin sa më të mirë të llozës dhe sigurtimit të një drenazhi të mirë, sidomos për të menjanuar grumbullimin e koagulave, gjë që ne e kemi pasur parasysh në të gjithë të sëmurët e operuar në klinikën II me këtë metodë. Dihet se vetëm meazhi i prostatës shtron në gjak fosfatazën acide, në rastin e prostatëktomisë, mund të shkaktojë një koagulum intravezikal, i cili, duke konsumuar fibrinën, jep hemorragji, që mund të zotë-rohet vetëm me gjak të freskët që i ka të gjithë faktorët koagulues,

rragjise dhe ne formimin e nje llozhe sa me fiziologjike, per te menja-nuar sa te jete e mundur stenozat pas operacionit.

Modifikimi i Denisit gendron ne ndarjen e permbajtjes vezikale nga llozha vezikale, pasi sa me e plote te jete hemostaza dhe sa me e thate te jete llozha prostatike, gka sigurohet me thithje dhe depression te llozhes, gjithashtu sa me pak gjak te kete ne veziken urinare, qe me mire sheronet dhe epitelizehet llozha dhe qe me te pakta do te jene nderliktimet e saj si skleroza e gafes etj., nganjehere me simpotomato-logji me te rende se vete adenoma e prostatas.

Si ne literature, ashtu dhe ne rastet tona, kjo metode ka perparesi. Kjo duket edhe ne dekursin fill pas operacionit dhe ne dekursin e larget.

Dorezuar ne redaksi me 5.8.1984

BIBLIOGRAFIA

- 1) Dennis R.: Prostatectomie sous depression. Annales d'urologie, 1973, 7, 14.
- 2) Niederhausem W.: Mesure de la miction apres la prostatectomie sous sonde uretrale. Annales d'urologie, 1983, 17, 20.
- 3) Tomasin X., Motys C.: La Cryocauterisation prostatique, indications et resultats d'une serie de quatre vingtonze malades. Annales d'urologie, 1983, 6, 263.

Summary

TRANSVERSICAL PROSTATECTOMY

The paper describes the cases of transversical prostatectomy admitted to and treated at Clinic No 2 during the year 1984. After every prostatectomy with open bladder arise postoperative problems difficult to overcome and which often give rise to complications with serious consequences for the patient. To avoid these complications, this new surgical was introduced in our clinic with promising results and should be adopted also by the other surgeons urologists.

LA PROSTATECTOMIE TRANSVERSICALE

Résumé

L'auteur décrit des cas qui ont subis une prostatectomie transversicale et traités dans le service d'urologie de l'hôpital No 2 de Tirana pendant l'année 1984. La prostatectomie à vessie ouverte créait des problèmes post-opératoires qui parfois étaient difficile à résoudre ainsi que des complications avec des conséquences pour les malades. Pour éviter ces complications l'auteur a appliqué cette nouvelle méthode d'opération qui a eu des résultats prometteurs et qui peut être aussi adoptée par les autres chirurgiens urologues.

TE DHENA ANATOMO-KIRURGJIKALE TE VENDREDHJES SE VENA SAPHENA MAGNA NE VENA FEMORALIS

— EDMOND KAPEDANI —

(Spitali klinik nr. 2 — Tirane)

Venat varikoze te gjymtyrëve te poshtme jane nje patologji e

shpeshate. Rreth 33.7% e grave dhe 31.5% e burrave, qe kane si prote-sion nje pune me gendrtme ne kembë vuanë nga kjo semundje (9). Rreth 20% e popullise vuan nga venat varikoze (4). Ne sherbimin ambulator ajo perben 12% te vizitave kirurgjikale (3). Per shkak te shpeshatesise se saj, qe kap moshat e arta per pune, per shkak te nder-likimeve disa here tepër te renda qe jep, kjo semundje futet ne grupin e semundjeve me rendeasi mjekesore-shogërore (3).

Te gjitha venat varikoze parësore mjekohen me operacion. Ky operation ndjek keto momente kryesore:

1) Heqja e vena saphena magna dhe / ose vena saphena parva.

2) Heqja ose shkatërrimi nen lekure i te gjithë zgjerimeve vari-koze ne gjymtyrë.

3) Lidhja apo shkatërrimi i venave lidhëse midis sistemit sipërta-gësor dhe te thelle, kur ato jane insuficiente.

Ne kirurgjine bashkëkohore ka nje mendim te njezshem mbi do-mosdoshtmerine e heqjes se vena saphena magna, si edhe te lidhjes dhe prerjes se venave qe derdhen ne pjesën pertundimtare te saj. (vena affluentes).

QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i ketij artikulli është qe te japë njohuri per menyren e derdhjes se venave affluente ne vena saphena magna, gka ka rendeasi te madhe praktike per operacionin, sepse moszbulimi i mire i tyre ben qe ato te harrohen pa u lidhur dhe pa u prerë. Kjo gjë, heret e vonë sjell ne menyre te pashmanqshme persërtitjen e semundjes. Der-dhja e ketyre venave ne vena saphena magna nuk behet gjithnje nje-lloj (4, 5, 6). Per kete arsye, është e domosdoshme njohja e topografise te fundit ne vena femoralis.

Kahimi nga pjesa përfundimtare me mur të hollë i *vena saphena magna* në *vena femoralis* me mur të trashë bëhet me një kënd të ngushtë. Kështu, ndryshimi i ngjyrës së murit të venës paraqitet në formën e një kordonit të bardhë, në formë ovale, që rrethom, duke e pushtuar, vend-takimin e të dy venave të përmendura më lart (5). Kjo është një zonë që kirurgu duhet ta dallojë mirë dhe gartë me anë të një preparimi të kujdesshëm të indëve që ndodhen rreth këtyre vendtakimi. Pikërisht rreth kësaj të ashtuquajturë «vijë e bardhë» duhet të vendoset lidhja ndarë-se midis *vena saphena magna* dhe *vena femoralis* dhe 0.5 cm larg saj duhet të bëhet prerja e *vena saphena magna*.

PËRFUNDIM

BIBLIOGRAFIA

1) Dodd H., Cockett F.: The Pathology and Surgery of the Veins of the Lower

Limb. London, 1976.

2) Kachel TH., Seidel J., Wolf O.: Ursachen der Rezidiv-verikositas an der Unteren

Extremität. Zentralblatt für Chirurgie, 1985, 4, 249.

3) Kapedani E.: Mjekimi kirurgjikal i venave varikozë të gjymtyrëve të poshtme

me metodën e varicetomisë subkutane. Punime kirurgjikalë 1985, 7, 67.

4) Kappert A.: Diagnose und Therapie des Arterienler-, Venoser und Lymphatischer

Erkrankungen. Wien, 1981.

5) Malan E., Agrifoglio G.: Le Traitement chirurgical de l'insuffisance veineuse

periphérique. Né: Aspects importants de l'insuffisance veineuse chronique.

Paris, 1971.

6) Martev A. J., Dubanov J.P.: Podkozhnaja safenotomika pri varikoznoj boleznii ven

nizhnih konegnozej. Vestnik hirurcii, 1984, 5, 78.

7) Metrose D.G. and coll.: The Stripping of Varicose Veins: A Clinical Trial of

Intermittent Compression Dressing. Brit. J. of Surg. 1979, 66, 53.

8) Scognamiglio F.: La nostra esperienza nelle varici recidive della terapia chirur-

gica delle varici degli arti inferiori. Minerva chirurgica, 1977, 32, 87.

9) Wiedmer L.K.: Venerkerkrankungen bei 18000 Berufstätigen. Schweizer Medizini-

sche Wochenschrift, 1967, 97, 18.

Summary

ANATOMO-SURGICAL FINDINGS CONCERNING THE SITE OF ENTRY OF THE SAPHENA MAGNA VEIN INTO THE FEMORAL VEIN

The paper points out the necessity of a perfect knowledge of the anatomy of the site in which the *saphena magna* joins the femoral vein for any surgical intervention to be performed in that region. It describes the possible anatomic variations encountered of the veins tributary to the femoral vein.

MATERIALI DHE METODA

Materialet i studimit përbëhet nga 120 të sëmurë me *vena varikozë* parësore të gjymtyrëve të poshtme, të cilat janë operuar duke kryer

heqjen e *vena saphena magna* me stripër, të shqogëruar me varicetomi

subkutane. Në metodikën e punës sonë kemi pasur parasysh që, gjatë

operacionit të vëzhgojmë variacionet anatomike të sistemit venoz si-

partaqësor, si edhe të realizojmë heqjen e tërësisë së *vena saphena*

magna, që është një premisë bazë për mjekimin e kësaj sëmundjeje.

Këtë e kemi kryer nëpërmjet tri momenteve të mëposhtme:

1) Zbulimi dhe përgatitja e vendit ku *vena saphena magna* derdhet

në *vena femoralis*.

2) Zbulimi para *maleolus medialis* i pjesës fillëstare të *vena sa-*

pheua magna.

3) Futja e stripërit në *vena saphena magna*.

Momenti më kryesor është zbulimi dhe përgatitja e vendit ku

vena saphena magna derdhet në *vena femoralis*. Këtë e kemi realizuar

me një prerje 1 cm mbi *plica inguinalis*.

Duke u bazuar në studimin e këtyre 120 operacioneve, kemi vënë

re këtë shpeshësi të genies të venave derdhëse; *vena pudenda super-*

ficialis — 109 raste (99%), *vena epigastric superficialis* — 104 raste

(95%), *vena circumflexa ilium superficialis* — 95 raste (75%), *vena*

(40%). Pra, jo të pesë venat derdhëse janë përherë të pranishme në pje-

sen përfundimtare të *vena saphena magna*. Në 90% të rasteve ato der-

deshin në 3 centrimetrat e fundit të *vena saphena magna*. Dërdhja e

tyrë bëhet topografikisht jo gjithnjë njëjloj si në normë.

Në 80 të operuar, vendosja e tyre ishte si në normë, ndërsa 40 të

operuar të tjera paraqesin variacionet e mëposhtme të paraqitur në

figurë.

Vena saphena magna detrymishisht duhet të lidhet me vendtakimin

e saj me *vena femoralis* (1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8).

Lidhja e saj larg këtyre vendtakimi, krijon një cunq të *vena saphena*

magna, i cili bëhet një xhap i përshtatshëm për të formuar tromb.

Ky tromb rezikon të shkëputet dhe të japë tromboemboli, me gjithë pasojat

e saj serioze. Kur lidhja vendoset nën këtë vendtakimi safeno-femoral,

ajo detrymishisht sjell ngushtimin e *vena femoralis*, duke penguar rrjedhën

normale të gjakut në gjymtyrët e poshtme me gjithë pasojat e saj (3,5).

Nevoja për ta vendosur lidhjen pikërisht në vendin ku *vena sa-*

pheua magna bashkohet me *vena femoralis* na ka detryuar të vëzhgojmë

paraqitjen e këtyre vendtakimi. Kemi vërtetuar se genia e të ashtuquaj-

turës «vijë e bardhë» (5,8) është një vend i vlershëm orientues. Pjesa

përfundimtare e *vena saphena magna*, në një gjatësi 2 cm nga vendi ku

ndodhet valvula e saj e fundit deri në vendin ku ajo derdhet (1, 5, 8),

është e tensionuar dhe ka në ngjyrë si në blu. Kjo ngjyrë vjen nga tej-

dukshmëria e murit të venës, që në këtë vend është më i hollë se në qdo

pjesë tjetër të saj (4,5,8).

Në vendin ku *vena saphena magna* bashkohet me *vena femoralis*,

FIG. MANRYAT E DERDHJES SE VENAVE AFFIENTE NE U. S. M.

I - NORMA II VARIACIONET ANATOMIKE

V. F. = Vena femoralis, V. S. M. = Vena saphena magna.



V. E. S. = Vena epigastrica superficialis.

V. P. E. = Vena pueraria externa.

V. C. I. S. = Vena circumflexa iliaca.

V. A. L. = Vena anteborbitalis.

V. P. M. = Vena portohemadialis.



The paper confirms the existence of the so-called «ligne blanche» in which the ligature separating the saphena magna should be applied. Both these moments are considered necessary to the prevention of relapses of varices in the vein.

Résumé

DONNEES ANATOMO-CHIRURGICALES CONCERNANT L'ENDROIT DE PENETRANCE DE LA VEINE SAPHENE INTERNE DANS LA FEMORALE

L'auteur met en évidence la nécessité de bien connaître la topographie de la région où la veine saphène interne pénètre dans la veine femorale en vue d'interventions possibles chirurgicales dans cette région. Il décrit les variétés anatomiques possibles de pénétration des veines tributaires dans la veine femorale. L'auteur confirme l'existence de la soi-disant «ligne blanche» où on doit poser la ligature qui sépare la saphène interne. Ces deux moments sont considérés comme nécessaires pour la prévention des récidives des varices.

DISA TE DHENA MBI MJEKIMIN, DIAGNOZEN DHE MJEKIMIN
E TUMOREVE MALINJE, TE GJUHES

— Doc. DHORI POJANI —

(Klinika e kirurgjise stomatologjike)

Sipas te dhënave statistikore te shumë autoreve (3,4), rreth 10-20% e gjithë tumoreve malinje u përkasin buzëve, gjuhës dhe mukozave të zgavres së gojës, kurse kanceri i gjuhës (1, 6, 8, 10) përben rreth 20% të te gjithë tumoreve malinje dhe 28-69% (3, 10) e te gjithë tumoreve të zgavres së gojës, duke zënë vendin e parë ne këtë zone, pas atyre të buzës.

Ne këtë punim, i vumë vetes për qëllim të japim disa të dhëna mbi tumoret e gjuhës, sidomos malinje, format klinike dhe sqarojmë disa nga shkaqet e gabimeve në diagnostikimin e formave fillëstare të kancerit të gjuhës, si edhe të japim përvojën tonë në trajtimin e kësaj patologjie.

Ne peritdhën që marrim në studim, 1971-gusht 1981, në klinikën tonë janë paraqitur 22 raste me tumore (karcinoma 20 raste dhe cili-ndroma 2 raste). Sipas të dhëna të literaturs, kanceri i gjuhës zhvillohet më shpesh në meshkuj sesa në femra (7:1) (2,6,9). Edhe në materialin tonë kemi 20 raste dhe 2 raste në gra (10:1). Nga të dhënat e materialit tonë, shpeshësinë e lartë të kancerit të gjuhës në burrat ne e shpjegojmë me abuzimin nga ana e tyre në pirjen e duhanit, të alkoolit, me kujdesin e pamjaftueshëm për higjienën e gojës, mosvlerësimin sa duhet të gjendjeve parakanceroze prej tyre etj. Këto përfundime përputhen me ato të shumë autoreve të tjerë (1,9).

Në literaturë (1,3,9,10), pranohet se lokalizimi më i shpeshë i kancerit të gjuhës është në pjesët anësore dhe në rrethjen e saj, që korrespondon me zonën e dhëmballëve dhe paradhëmballëve, dhe më rrare dhe zhvillohet në pjesën shpinore, majën dhe pjesët e tjera të saj. Sipas të dhënave tonë, në 15 raste (70%) tumori ish lokalizuar në anët e gjuhës, në 4 raste (15%) në rrethjen e gjuhës dhe bazën e saj dhe në 3 raste (13%) në sulksin nofullor-gjuhhor.

Shpeshësinë e lartë të kancerit të gjuhës në anët dhe buzën e gjuhës, ashtu si shumë autorë, edhe ne e shpjegojmë me ngacmimet e vazhdueshme që japin dhëmbët e prishur, rrethjet ose protezat. Sipas materialit tonë, rezultoni që në 10 raste kemi gjetur dhëmbë të prishur ose rrethjet (molare ose premolare), kurse në 7 raste proteza ose ura të vjetra e të papërshtatshme. Në 5 raste e tjera faktorit favorizues ngacmues nuk ishte përcaktuar. Por në 3 prej tyre, sig rezultoi nga ana-

meza dhe ekzamini, mungonte higjiena e mirë e gojës (kjo e fundit mungonte edhe në 17 rastet e tjera). Gjithashtu, shumica e tyre abuzo- nin në pirjen e duhanit. Lidhur me shpeshësinë e kancerit të gjuhës në varësi nga moshë, kemi këto të dhëna; nga moshë 31-40 vjeç — 2 raste, 41-50 vjeç — 5 raste, 51-60 vjeç — 6 raste dhe mbi moshën 60 vjeç — 9 raste. Nga të dhënat tona, rezulton se, ashtu siç pranohet nga autorë të tjerë (1,3,9), kanceri i gjuhës takohet më shpesh në moshat mbi 40 vjeç. Në materialin tonë, 20 raste ose 90% të kancerit të gjuhës i kemi në moshën mbi 40 vjeç.

Koha nga shfaqja e dëmtimit fillestar të kancerit të gjuhës deri në paraqitjen e të sëmurit të mjekës stomatolog ose i përgjithshëm lëviz nga 2 muaj deri në 1 vit për 16 rastet tona me karcinomë. Dy rastet me cili- ndronjë janë paraqitur të mjekës ose tek ne me shumë vonësë.

Nga të dhënat e anamnezës, del se paraqitja me vonësë ka ardhur për këto arsye: së pari, nga ana e mjekut nuk është menduar se kemi të bëjmë me gjendje parakanceroze ose kancer të gjuhës, por është bërë mjekim me antibiotikë ose mjekime të tjera, madje në një rast me numër kartele 592, datë 20.1.1981 është bërë ndërhyrje për sialoadenit dhe është dërguar te ne pas një viti me neuralgji të notullës. Së dyti, në disa nga rastet tona janë zhvilluar tumore pa simptoma ose turbullime lokale e të përgjithshme, të lehta e të ngadalshme, që pak i kanë shqetësuar të sëmu- ret. Këta nuk e kanë vlerësuar si duhet sëmundjen dhe janë paraqitur dhe kur tumori kishte marrë përmasa të konsiderushme.

Të tërheq vëmendjen fakti se, nga të dhënat e anamnezës, rezulton që sëmundja në 16 raste (73%) ka filluar si ulcër e vogël ose si plagë dekubitale në anët e gjuhës në sulkusin notullorë-gjuhor. Në 6 raste (27%), procesi neoplazik ka filluar si një një ose infiltrat me ntrashje të gjuhës pa dhembje. Brenda disa muajve (2-4 muaj) kjo njëje është ulcëruar, duke marrë formën e kraterit me përmasa të konsiderueshme. Këto të dhëna përforcojnë atë që thuhet në literaturën se kanceri i gjuhës fillon si parakanceroze (1,2,3,11).

Sipas të dhënave të literaturës (4) dhe të klinikës sonë kanceri i gjuhës ka një zhvillim shumë më të shpejtë se kanceri i buzës dhe mu- materialit tonë, del se në 15 raste (70%) zhvillimi i tumorit është bërë shumë shpejt, duke kaluar nga gjuha në dyshëmene e gojës e ana- sjelltas.

Klinikiisht 15 të sëmurët, kur janë paraqitur pranë klinikës sonë, kanë pasur këto ankessa subjektive; shumica ka pasur dhembje të forta në gjuhë e me përhapjen në dhembje, notullë, dyshëmene e gojës dhe aurikulo-temporale, hemorragji të pakta të vetvetishme ose gjatë marr- jes së ushqimit, njëje të shijës, veshtrësi në marrjen dhe gëlltitjen e ushq- mit, kutizim dhe zmadhim të gjuhës. Në 7 rastet dhembjet në gjuhë kanë gene të lehta, me djegie dhe kruarje të saj. Objektivisht vëmë re ulcëre me përmasa të ndryshme, me ntrashje e zmadhim të gjuhës, në prekje, me pritje për hemorragji dhe ertë të keqe nga goja (*fetor ex oris*). Gje- ndja e përgjithshme ka gene e mirë, vetëm në dy raste ajo ka gene e mesme me temperaturë të lartë, pasi karcinomën e shogëronte infek-



Foto 1



Foto 2

sioni dytësor. Pasi këta të sëmurë u trajtuan me antibiotikë, gjendja e përgjithshme u përmirësua brenda 10 ditëve.

Sipas stadii klinik të kancerit të gjuhës, të sëmurët tek ne janë paraqitur në këtë mënyrë: në stadin I — 5 të sëmurë, në stadin II — 6, në stadin III — 8 dhe në stadin IV — 3 të sëmurë. Për gjysma e të së- murve janë paraqitur në stadin III dhe IV, kur dihet se mjekimi murrëve janë paraqitur në stadin III dhe IV, kur dihet se mjekimi është i veshtrë nga përhapja e madhe e sëmundjes dhe metastazat zonale ose në distancë.

Sipas të dhënave histopatologjike, vëmë re se më tepër është ta- kuar forma shpinogelitore e diferencuar mirë e birtëzuar në 16 raste (82%). Kjo e dhënë përkon edhe me të dhënat e autorëve të tjerë. Këto forma i kanë gjetur nga 90-95% (3,5,9).

Si në tumoret e tjerë të regjionit maksilo-facial, edhe në tumoret malinjë të gjuhës metastazat përhapen me rrugë limfatike (3,4,9). Shka-

ku i metastazave të hershme e të përhapura shpërgjohet me faktin se gjuha është organ me rritje të shumtë të pasur enësh limfatike dhe gjaku dhe me lëvizshmëri të saj të madhe (9). Formimi i metastazave varet kryesisht nga stadi i kancerit, por kjo nuk duhet absolutizuar, sepse edhe në stadin e parë e të dytë mund të zhvillohen metastaza në afërsi, ashtu siç ndodh në kancerin e buzës (9). Ato zhvillohen kryesisht në gjëndrrat limfatike nën notull, anash gatës sipërfaqësore dhe të thella, retroartikulare, mjekrës, përreth fytit e sipër klavikules. Rrallë mund të metastazojnë në organet e tjera. Në kemi pasur një rast me metastazë të mushkëri dhe në gjëndrrat nën notullën e poshtme të njëanshme dhe të dyanshme — 10 raste (45,4%) të vërtetuar me ekzaminimin histopatologjik; në 5 raste metastazat janë zhvilluar më vonë, megjithëse në paraqitjen e parë ato ishin të paprekshme. Nga 10 raste me metastaza, pesë prej tyre kanë gënë me metastaza të shumta (nënnotull, anash gatës, mbi klavikul etj.).

Në disa raste kanceri i gjuhës dhe i dyshemessë së gojës shqetësohet edhe me dukuri inflamatore, të cilat japin ndryshime në kuadrin e gjakut, gjë që kemi vënë re edhe në rastet tona dhe mund të bëhen shkak për formimin e linoadenitave reaktive, prandaj çdo acarim i gjëndrrave limfatike regjionale nuk duhet të merret si metastazë. Pas heqjes së tyre dhe ekzaminimit biptik, rezultoi se ato ishin me limfoadenite reaktive jomestastike.

Edhe për klasifikimin e kancerit të gjuhës, përvëç ndarjes së tij në katër stade, duhet të përdoret gjëresisht sistemi T.N.M., i propozuar nga komiteti ndërkombëtar për studimin e klasifikimin klinik të tumoreve gjyha në vitin 1969, gjë që keshillojnë dhe shumë autorë të tjerë (4, 5).

Në bazë të sistemit T.N.M.T-ja përtfaqëson tumurin parësor, N (nodul-lab) gjëndrrat limfatike dhe M metastazat e largëta, T₁ — tumori me diametër deri 2 cm sipërfaqësor pa infiltrim në meshkuj, T₂ — tumori me diametër rreth 2 cm, por me zhvillim në mushkulaturën e gjuhës, T₃ — tumori mbi 2 cm dhe zhvillim në thellësi të gjuhës, N — pa limfonodula të prekura, N₁ — limfonodula që preken të njëanshme dhe të levizshme të dyshemessë pa metastaza, N₂ — limfonodula të dyanshme me metastaza të levizshme, N₃ — limfonodula të prekshme të fiksuara të njëanshme ose të dyanshme, M — pa metastaza në distancë, M₁ — me metastaza në distancë.

Me anë të këtij klasifikimi, tregohen përmasat e tumorit, gjëndja e limfonodulave regjionale dhe nëse ka metastaza ose jo në organet e tjera në distancë. Në këtë mënyrë, tërhiqet vëmendja për një ekzaminim të plotë të të sëmurit dhe nga mjeku i specialist.

Nga 11 raste të operuar në stadin I të II, kemi ndjekur 8 raste. 6 prej tyre janë operuar para 2-3 vjetëve dhe janë mirë, nuk kanë rishfaqje dhe metastaza. Për 11 rastet e tjera që kanë gënë në stadin II dhe IV, rezultatet nuk kanë gënë të mira. Në vatrën parësore, në 5 raste nuk ka pasur rishfaqje por të sëmurët kanë pasur metastaza. Ato janë rrezatuar (pasi u është bërë heqja e gjëndrrave). Rezultatet nuk kanë gënë të kënaqshme. Në 6 rastet e tjera tumori ka gënë shumë i përhapur dhe nuk është bërë ndërhyrje. Në 3 prej tyre është bërë rrezatimi.

Ndërhyrjen kirurgjikale për heqjen e tumorit e kemi bërë në këtë

mënyrë: kur tumori ka gënë i lokalizuar në gjysmën e përparme dhe në mesin e gjuhës, heqja është bërë duke tërhequr gjuhën me ligaturë dhe me prerjen e masës neoplaztike në kufi të shëndosha 1 cm larg tumorit, gjithmjet në pjesë të shëndosha. Heqja e masës (preja) është bërë në formë pyke. Kur tumori ka gënë i lokalizuar në rrethjen e gjuhës ose nën të, kemi përdorur këtë teknikë operatorë.

Për të pasur një fushë me pamje sa më të mirë për heqjen e tumorit, kemi bërë heqjen transversale në fagen nga këndi i gojës deri tek muskulli masester. Mandej heqja e masës neoplaztike është bërë në formë pyke. Në një rast me gënë se tumori ishte shumë i përhapur është ndërhyrë me rrugë nënnotullore duke bërë thyerje të notullës së poshtme në regjionin e molarëve.

Ashtu siç rekomandohet edhe nga autorë të tjerë, në 7 raste operacioni për heqjen e tumorit e kemi bërë pasi lidhjes së arteries karotide të jashtme. Kjo ka ndihmuar për të pasur një fushë operatorë me he-morragji më të pakët dhe pamje më të mirë. Heqja e metastazave është bërë në të njëjtën etapë së bashku me heqjen e vatrës parësore e tjera heqja është bërë lidhja e arteries karotide të jashtme. Për rastet e tjera heqja është bërë më vonë, pas 3-4 javëve, kur në kemi gënë të bindur për metastaza. Për ato që kanë gënë të dyshemessë, të sëmurët janë mbajtur nën kontrollin e mjekut për të parë ndryshimet në gjëndrrat regjionale të dyshemessë.

Të gjitha rastet e operuara pas 2-3 javësh nga dita e operacionit janë konsultuar me onkologun, radioterapeutin dhe sipas porosisë të tyre të sëmurëve u është zbatuar kobalt ose radioterapi.

PËRFUNDIME:

1) Për diagnostikimin e hershëm të tumoreve malinje të gjuhës dhe dyshemessë së gojës dhe mjekimin në kohë të bëhet menjëherë ekzaminimi histopatologjik ose, në të kundërtën, të dërgohet sa më parë i sëmurit tek kirurgu stomatolog.

2) Të shmanget përdorimi i antibiotikëve pa kriter ose i mjekimeve të tjera kur nuk është përcaktuar ende diagnoza dhe kur mungojnë të dhënat klinike për proces inflamator.

3) Kanceri i gjuhës dhe i dyshemessë së gojës është një sëmundje e shtrueshme kur ajo diagnostikohet në kohë, pa dhënë metastaza të afërta ose të largëta dhe kur mjekimi bëhet kompleks në bashkëpunim të ngushtë midis kirurgut stomatolog dhe onkologut radioterapeut.

4) Mjekimi i kancerit duhet bërë që në stadin I dhe II me trajtim kirurgjikale të shogëruar me Ro-terapi dhe heqje të gjëndrrave metastastike të dyshemessë.

Dorëzuar në redaksi më 9.7.1984.

PERVOJA E JONE NE TRAJTIMIN E 80 RASTEVE ME THYERJE NE REGIONIN MAKSILO-FACIAL

— TAHIR DURO —

(Instituti Kërkimor i Mjekësisë Ushtare)

Problemi i thyerjeve maksilo-faciale, megjithëse është i njohur prej kohësh, mbetet sot një problem i rëndësishëm i kirurgjisë maksilo-faciale si në drejtim të patogjenezës, ashtu edhe në atë të trajtimit të tyre.

Në materialin tonë bëhet analiza e 80 rasteve të thyerjeve maksilo-faciale të trajtuara në repartin e stomatologjisë të IKMU-së në vitet 1970-1982. Të ndara sipas viteve, shpeshësinë më të madhe e përbejnë ato të viteve 1976-1980 me 41 raste ose 51.250/0. Pas tyre vijnë ato të viteve 1970-1975 me 22 raste ose me 27.50/0, ndërsa 17 raste ose 21.250/0 u takojnë viteve 1981-1982.

Në varësi nga seksi, rastet ndahen në 79 meshkuj dhe 1 femër, ndërsa sipas moshës shpeshësinë më të madhe e paraqesin ato të moshës nga 16-21 vjeç me 36 raste. Pas tyre vijnë ata të moshës 22-26 vjeç me 34 raste, ndërsa në moshat e tjera ka gjithsej 10 raste. Lidhur me profesionin, për vetë natyrën e institutit tonë, 56 raste u takojnë me ushtarëve me 70/0, 16 punëtorëve me 20/0 dhe 8 kuadrove me 10/0. Shkaku i thyerjes në 49 raste (61.250/0) kanë qenë goditje të drejtpërdrejta në regjionin maksilo-facial, në 14 raste (17.500/0) kanë qenë rrejtë si pasojë e rrezimeve nga lartësia, 11 raste (13.750/0) kanë qenë aksidentente rrugore, 5 raste (6.250/0) aksidentente sportive dhe 1 rast (1.450/0) dëmtime me armë zjarri.

Lidhur me lokalizimin e vijave të thyerjes në notullën e sipërme, paraqiten 22 dëmtime që ndahen: në procesin alveolar 8 raste (360/0), në trupin e maksilës (Lëtor I) 3 raste (13.640/0), në kockën xikomatike 8 raste (36.360/0), në kockën itraorbitale 1 rast (4.540/0), në kockën nazale 2 raste (9.100/0). Kurse në notullën e poshtme kanë qenë 58 dëmtime, të ndara si më poshtë: në procesin alveolar 2 raste (3.440/0), në regjionin medial 3 raste (3.180/0), në regjionin paramedial 12 raste (20.680/0), në trupin e mandibulës 9 raste (15.500/0), në këndin e mandibulës 28 raste (48.300/0), në degën ngjësë 1 rast (1.720/0) dhe në procesion artikular 3 raste (5.180/0). Thyerjet lineare pa copëzime kanë (150/0) dhe një rast (1.250/0) ka qenë me copëzime të shumta.

Sipas rëndësës së dëmtimit, thyerjet i kemi pasur të hapura dhe të mbyllura. Lidhur me këtë, shpeshësi më të madhe paraqesin thyerjet e mbyllura me 44 raste (550/0), ndërsa thyerjet të hapura kemi pasur 36 raste (450/0). Dëmtimet e indeve të buta kanë qenë të larmishme.

BIBLIOGRAFIA

- 1) Argunova I.P.: Rak organov polosti rta. Stomat. 1962, 1, 89.
- 2) Barsheva I.D. e bp.: Zlokalgestvennie krasnogo ploskogo lishaja slizostoj obo-logki rta. Stomat. 1974, 3, 80.
- 3) Bernadski I.: Osnovi hirurzijskoj stomatolog. Kiev, 1970, 405.
- 4) Giordino C., Jonta G.: Il carcinoma della lingua. Minerva stomatologica. 1978, 4, 261.
- 5) Gjini S.: Disa konsiderata të përgjithshme mbi klinikën dhe mjekimin e kancerit të buzës. Buletini i UT-Seria shkenca mjekësore 1981, 1, 93.
- 6) Ivashenko A.I.: Spravochnik po stomatologii. Moskva, 1966, 96.
- 7) Kasapi I.: Të dhëna klinike e mjekimi i adenopative metastatike në tumoret malinje të regjionit të gojës, notullave dhe fytyrës. Buletini i UT-Seria shken-cat mjekësore, 1982, 1, 87.
- 8) Pages A.I.: Voprosi prepodavanija onkologii geljustno licevoj pliasii v medicinskij institut stomat. Tirane, 1971, 5, 74.
- 9) Rroku C.: Morfologjia patologjike. Tirane, 1975, 361.
- 10) Stepanov V.M.: Nagalnie formi raka jazika i oshpiubki diagnostik stomat. 1981, 4, 45.
- 11) Vasokovskaja e bp.: Razvitie raka na ogagah krasnogo ploskogo lishaja slizostoj obo-logki polosti rta i krasnoj gub. Stomat. 1981, 3, 4.

Summary

SOME DATA ON THE CLINICAL PICTURE, THE DIAGNOSIS AND THE TREATMENT OF MALIGNANT TUMOURS OF THE TONGUE

Some problems regarding the tumours of the tongue are discussed particularly the malignant tumours, their presumed causes, their clinical forms, their evolution, the errors made in their diagnosis. The discussion is illustrated with the author's experience in the treatment of 23 cases during the period between 1971 and 1981.

QUELQUES DONNEES CLINIQUES, DE DIAGNOSTIC ET DU TRAITEMENT DES TUMEURS MALIGNES DE LA LANGUE

Résumé

L'auteur discute quelques problèmes concernant les tumeurs de la langue, particulièrement les tumeurs malignes, leur causes, leur formes cliniques, l'évolution, les erreurs faites dans leur diagnostic. La discussion est illustrée par l'expérience de l'auteur dans le traitement de 23 cas pendant les années de 1971 à 1981.

DISKUTIM

Në sajë të shtrirjes së ndihmës së specializuar në të gjithë vendin kor e të specializuar, prandaj edhe raste të Institutin tonë nuk janë thyerje maksillo-faciale të lëna pas. Në shumicën e tyre, ato janë thyerje të freskëta të ardhura brenda 6 orëve dhe me ndihmën e parë. Kjo ka bërë që edhe trajtimi i tyre të jetë pa ndërlikime. Duhet theksuar se si në kohë pagëje, edhe kohë lufte koha e dhënies së ndihmës së parë është e rëndësishme për ecurinë e thyerjeve maksillo-faciale, sidomos ato të tanishmë, ndër shkaqet e thyerjeve maksillo-faciale, sidomos ato të mandibulës, goditjes zënë vendin e parë. Ndërsa në vendet e tjera (5) përqindjen më të madhe të demtimitve e përbejnë aksidentet rrugore. Pozitive është se, për kontingjentin tonë të ri, thyerjet nga sportet janë të pakta. Kjo për vetë kujdesin që tregohet. Thyerjet në regjionin maksillo-facial në materialin tonë dalin 1 me 2,6 për mandibulën. Një autor (1,2) i ka pasur 1 : 6 për mandibulën, të tjerë (5) i kanë pasur 1,3 për mandibulën. Ky raport shpjegohet me faktin se mandibula është më e pre-dispozuar që t'u nënshtrohet shkaqeve etiologjike të thyerjeve dhe se kjo kockë jo vetëm që zë sipërfaqe të madhe në fytyrë, por është edhe pjesa më e ekspozuar e saj.

Kanë interes thyerjet në regjionin e artikulationit tempo-mandibular, të cilat vite më parë, jo vetëm tek ne, por edhe në vende të tjera, shkaktonin alkilozat traumatikë që invalidizojnë të demtuarin. Për këtë, trajtimi fillëtar i thyerjeve të këtij regjioni kërkon trajtim terapeutik dhe kirurgjikal të drejtë dhe në kohë me anë të perjes së zones së demtuar dhe plastikës së saj. Demtimet e indeve të buta në thyerjet maksillo-faciale kanë specifikën e tyre në përpunimin kirurgjikal, prandaj në kemi ndjekur me rreptësi moshqejnë e pjesëve të demtuara, ruajtjen e pjesëve kockore që lidhen me pertostin, ruajtjen e pjesëve të demtuara të formacioneve neurofazale dhe kanaleve të nxjerrjes së peshlymës gjatë suturemit, ruajtjen e masivitetit muskular të regjioneve maksillo-faciale, të cilat kanë rëndësi për të mos prishur tërësinë anatomike të tij. Në thyerjet tërësore të proceseve alveolare dhe të dhëmbëve, i kemi hequr proceset e demtuara dhe dhëmbët që kanë qenë në vijën e thyerjes. Në të gjitha raste e demtimet të ndërthurura kockore dhe indeve të buta, pavarësisht nga rrjeti i gjërë vaskular i regjionit maksillo-facial, kemi përdorur mjekimin me antibiotikë, vitaminoterapi dhe zëvendësuesit e gjakut. Ka rëndësi të theksohet se nuk duhet pritur sa të sigurohet ndihma e specializuar, e cila, në kushte të veganta, mund të jepet më vonë, në kohën kur të jetë shman-gur rreziku për jetën e të sëmurit.

E dhe në kohë pagëje, por, me shumë akoma, në kohë lufte thyerjet maksillo-faciale nuk mund të hasen të vetme dhe pa ndërlikime të gjë-najës së përgjithshme të organizimit. Ato mund të jenë përberëse të traumazimit të përgjithshëm, duke u shogëruar me demtimit të thella të trurit, si komuzion, komocioni e deri tek hemorrhagjite e ja-shtme apo të brendshme vdekjeprurëse. Në këto raste, përplekjet e para synojnë shpëtimin nga rreziku imediat. Në to hyjnë edhe ndih-

Me gjendje të përgjithshme të rëndë kanë qenë 9 raste (11.25%); 6 kanë qenë me *comotio cerebri*, 1 me *comotio cerebri* dhe 3 raste me larmishme. Edema, prishje e kontiguracioneve, devijim copëzimesh, lëvizja e tyre u konstatuan në të gjitha raste gjatë ispektimit dhe palpimit ekstra-dhe intraoral. Në 62 raste (77.5%) u vërejt prishje e funksionit, ndër to 54 raste (67.5%) kanë pasur prishje të okluzionit të funksionit, 36 raste 45% kanë pasur hemorrhagji intra — dhe ekstraorale me ekimozë dhe edema. Simptoma e dhimbjes në të gjitha raset ka qenë me intensitet të ndryshëm. Në ekzamainmo radiologjik të bërë aty për aty në projeksione standarde dhe ndihmëse, është vënë re vija e thyerjes në të gjitha raste, duke dhënë vijën lineare në 67 raste (83.75%), me zhvendosje anësore dhe zgjatësore 32 raste (40%), me dy vija thyerjeje 12 raste (15%) dhe një rast (1.45%) me shumë co-pëzime.

Ndihma e parë tek të demtuarit tanë është dhënë në arkaden dentare në 68 raste (85%). Në indet e buta — 32 raste (40%). Lidhur me trajtimin përfundimtar, i cili është bërë pas marrjes së ndihmës së parë në kondita spitalore dhe sipas indikacionit për secilin rast, kemi parapëlqyer imobilizimin elastik mbimaksilar dhe ekstraror në 68 raste (85%); në 7 raste (8.75%) kemi përdorur osteosintezën metalike (tel-geliku të paokudueshëm 0.4 mm) dhe në 5 raste (6.25%) imobilizimi është bërë vetëm në arkadën e dhëmbëve të nofulës së demtuar pa fiksim intermaksilar. Raset janë vëzhguar çdo ditë, duke bërë mjeki-min e plagëve dhe 3-4 herë në ditë pastrimin e zgarvës së gojës me hidral kloral dhe esencë mente. Fiksimi elastik është ndjekur duke ndërruar unazat elastike të vendosura në harget e arkadave të dhë-mbëve deri sa është marrë okluzioni i rregullt midis dhëmbëve të kundërt. Në 9 raste me gjendje të përgjithshme të rëndë dhe ndërlikime kundërt me puls dhe tension në shtrirë e normale, i është dhënë për një kohë ndihma përkatëse për kontuzionin dhe komocionin cerebral. Pas daljes nga këto gjendje, të demtuarit i është bërë trajtimi përfundimtar i thyerjes në maksilë e mandibul.

Në ndërlikimet e hasura, përmendim hemorrhagjinë në 36 raste (45%) si rezultat i demtimitve indore lokale dhe vazave fundore, të cilat janë zotëruar me tamponatë dhe përpunim të plagës. Nuk kemi pasur raste të asfiksive apo të infeksionit ostemielitik; kjo edhe për mjekimin me gamen e gjërë të antibiotikëve, vitaminoterapinë dhe zë-vendësuesit e gjakut dhe raste të veganta të dhënies të gjakut. Në demtuarit janë ndjekur me radiografi mesatarisht çdo 20 ditë edhe pas daljes nga spitali. Kallusit kockor është krijuar mesatarisht pas 25 ditë-ve. Ditëqëndrimi mesatar i këtyrë të demtuarve ka qenë 25 ditë dhe ditët e pushimit mesatarisht 30 ditë.

ma kirurgjikale stomatologjike, pas së cilës jepet ndihma e specializuar për regjionin e dëmtuar.

Më poshtë po përshkruajmë një rast dëmtimi në regjionin maksillo-facial.

Pacienti A.X.H., 20 vjeç, me numër kartele 7056, u shtrua në kliniken tone më 11.9.1978 me diagnozën traumatizim i maksilës, i kockave të hundës, dëmtim i indeve të buta në buzë, në hundë, regjionin bukal, si edhe të indeve të buta të buzës së poshtme dhe të mandibulës në regjionin paramedian dhe angulës mendibulare të majtë. Në maksille dhe mandibular, pati dëmtim të proceseve alveolare në regjionet mandiane, si edhe të incizive të këtyre regjioneve. Shkaku i këtij dëmtimi të gjërë qe goditja gjatë punës në të gjithë regjionin e përshkruar nga një gur masiv i ardhur nga një lartësi rreth 1 m e gjysmë. I dëmtuari u paraqit me gjendje kome, atij i qe dhënë ndihma e parë për ndalimin e hemorragjisë dhe mbrojtjen nga asfiksia. Megjithatë këtu ne siguruan përshkruashmërinë e rrugëve të trymëmarrjes, hemostazën dhe rivendosëm voluminë normale, përcaktuam diagnozën e dëmtimeve. Megjë gjendja po vëstitrësohet, iu bë trakeotomia. Kur i dëmtuari iu nga gjendja komatoze, para se të fillohej operacioni i repomimit, iu bë përpunimi i kockave të hundës, të cilat genë të copëzuar; por të pashkëputura nga perioستي. Fillimisht në të dyja vrimat e hundës u vendosën dy tuba gome me trashësinë e vrimave të hundës, të mbuvendosën nga gaz të ljer me pomadë klorofenikol. Pas kësaj, u vendosën kockat në atërsi me normën, u qepën indet e buta mbi hundë, rreth hundës e buzës, mbi hundën u vendos garzë me klorofenikol dhe sipër saj stencë e zbutur, e cila, gjatë forcimit, mban kockat në pozicionin e vënë. Fiksimi i tij u bë me leukoplast. Në regjionin paramedian të mandibulës, pas krifimit të lambos mukoprostale, u bë osteosinteza nga ana e majtë, me tel geliku të paksidueshëm 0.4 mm. Pas heqjes së copëzimeve të procesit alveolar dhe të dhëmbëve në vijën e thyerjes, u qepën shtrësat e mukozave mbi proceset alveolare të dëmtuara, u vendosën harqet në të dy notullat dhe u bënë fiksimi elastik dhe fiksimi ekstraoral. Në fillim, të dëmtuari iu bë një serum antitetanik, iu mi ekstrorral. Në fillim, të dëmtuari iu bë një serum antitetanik, iu dha gjak izogrup dhe zëvendësuesit e tij dhe u trajtua me antibiotikë e vitamoterapi. Ndërlëkimet, si edema, ekimozat rreth syve dhe dhimbjet, filluan të zotërohen dhe pas 35 ditëve iu bë gratia e kontrollit, në të cilën u vu re formimi i kallusit. Pacienti doli i shëruar me 45 ditë pushim.

Krahas trajtimit klasik maksillo-facial me imobilizimin e harxheve në njërën ose në të dy notullat, sot përdoret gjërësisht edhe osteo-sinteza metalike, e cila krijon disa avantazhe si për të sëmurtin, ashtu edhe për mjekun. Përvoja jonë në këtë drejtim ka qenë e pakët. Për arrihen do të jenë subjekt i një komunikimi të mëvonshëm. Megjithatë bindja jonë është se trajtimi i këtyre thyerjeve me osteosinteze meta-like është një trajtim i kohës, racional dhe me efektshmëri të plotë.

PERFUNDIME

1) Në materialin tonë, shkaku kryesor i thyerjeve ka qenë goditja e drejtpërdrejtë në regjionin maksillo-facial (61.25%). Thyerjet më të shumta janë konstatuar në mandibul dhe, në të, më shumë në këndin e mandibulës (48.30%).

2) Shumica e të aksidentuarve janë paraqitur pas dhënies së ndihmës së parë mjekësore në një kohë të shkurtër, gjë që ka bërë që repomimi të jetë më i lehtë në marrjen e formës anatomofiziolgjike si dhe ditë-gëndrimet në spital dhe paartësia e përkohëshme të jenë më të shkur-tëra. Paraqitja në kohë për ndihmë të specializuar, si edhe shkaku i aksidentimit ka bërë që të mos kemi ndërlikime të hershme apo të vonshme.

3) Praktika jonë tregon se fiksimi intermaksilar elastik në thyerjet e freskëta, dhe të thjeshta jep rezultatet të mira. Në rastet më të ndër-likuara, si në ato me plagë të shaktuara me armë zjarri dhe në thyerjet me shumë copëzime, trajtimi duhet të jetë kompleks dhe bllokimi intermaksilar në përshtatje me metodat e kohës.

Dorëzuar në redaksi më 8.1.1985.

DENTIME TE INDEVE TE BUTA

14	ÇARIE TE BUZES
13	DENTIME EKSTRA ORALE TE INDEVE TE BUTA.
27	DENTIM ALVEOLAR
13	DENTIME ORGANIVE FOJNUE
13	DENTIMS TE NERVAVE E VREAVE
35	DENTIM / MUKOZES
28	DENTIM / SHENGEVE

LLOJI I AKSIDENTIT

49	61.25	14	17.58	11	13.75	5	6.25	1	1.25	80	100
	NR	NR	NR	NR	NR	NR	NR	NR	NR	NR	NR
	%	%	%	%	%	%	%	%	%		
GODITJE		REZIM NGA LARTESI		AKSIDE RRUQOR		AKSIDE SPORTIVE		DENTIM ARME ZJARRI		Shuma	
DIREKTE		LARTESI		RRUQOR		SPORTIVE		ARME ZJARRI		Shuma	

Načelnik zdravstvenega zavoda

NR	%	NR	%	NR	%	NR	%
36	45	34	42.5	40	42.5	80	100
K-21		22-26		26		SHUMA	
		E LART					

Načelnik zdravstvenega zavoda

USHTAR	PMETOR	KABRO	SHUMA
NR	%	NR	%
56	70	40	80
NR	%	NR	%
100	100	100	100

Shpërndarja sipas vikave e frakturave

SHUMA		1981-82		1976-80		1970-75	
NR	%	NR	%	NR	%	NR	%
22	27.5	41	51.25	47	21.25	79	98.75
NR	%	NR	%	NR	%	NR	%
1	1.25	1	1.25	1	1.25	1	1.25

BIBLIOGRAFIA

- 1) Asilani XH.: Frakturat e notullave të shkaktuara aksidentalisht ose me armë mjekësore, 1961, 1, 25.
- 2) Asilani XH.: Frakturat e notullave të shkaktuara aksidentalisht ose me armë zjarri. Frakturat e notullave, Tiranë, 1965, 5.
- 3) Duro T.: Kirurgjia fushore maksillo-faciale, Tiranë, 1969, 257.
- 4) Duro T.: Trajtimi i demtimëve maksillo-faciale me armë zjarri. Sesion shkencor në IKMU, 1978, 4.
- 5) Halftner M.: Untersuchungen über Gesichtssche del Frakturen under Besonderer derer Berücksichtigung der Infektiosen Komplikationen bei Konservativer und Operativer. Hamburg, 1974, 58.
- 6) Hesse J.: Die Frakturen des Gesichtsskelettes. Hamburg, 1970, 50.
- 7) Halftner M.: Untersuchungen über Gesichtssche del Frakturen under Besonderer Berücksichtigung der Infektiosen Komplikationen bei Konservativer und Operativer. Hamburg, 1974, 58.
- 8) Guan H.E.: Geteroosteostez nzhne] geljusti. Eksperimentaljno-klinigeskoe issledovanie, 1968, 1, 106.

Përvoja jonë në trajtimin e 80 rasteve me thyerje në regionin maksillo-facial. 123

- 8) Paul Natvig and coll.: Facial Bone Fractures. Ne Plastic Surgery. New York, 1973, 263.
- 9) Portman M.: Nez et face. Paris 1983, XV, 437.
- 10) Schwenger N.: Zur Osteosynthese bei Frakturen des Gesichtsskelettes. Stuttgart, 1967, 104.
- 11) Vogel Ch.: Osteosynthese und Infektion. Hamburg, 1975, 69.

Summary

OUR EXPERIENCE IN THE TREATMENT OF 80 CASES OF FRACTURES IN THE MAXILLOFACIAL REGION

A clinical study was carried out in 80 cases of maxillofacial fractures. The most frequent cause of these fractures was shock and the most frequent site was the angle of the mandibula, in 61.25% and 48.30% respectively. The delay os receiving first aid is important to the result of the treatment. The methods of treatment used were immobilization in simple fractures and osteosynthesis in complex fractures.

Résumé

NOTRE EXPERIENCE AU TRAITEMENT DE 80 CAS AVEC DES FRACTURES A LA REGION MAXILLO-FACIALE

L'auteur a étudié 80 cas avec des fractures maxillo-faciales et représente son expérience au traitement de ces cas. Selon l'auteur, les principales causes de ces fractures ont été les coups chez 61,25 des cas; la mandibule a été accidentée chez 48,30% des cas.

L'auteur donne la priorité chez ces malades la première aide et comme méthode du traitement il a appliqué pour les fractures simples l'immobilisation élastique, alors que dans les fractures compliquées, il a appliqué l'ostéosynthèse.

HIGJENË DHE EPIDEMIOLOGJI

DERMATOZAT PROFESIONALE TE PUNËTORET E NDERTIMIT
TE NDERMARRJES «21 DHJETORI» GJATE VITEVE 1973-1983

— VIOLETA GJINO —

(Klinika e dermatologjisë e Spitalit nr. 1 — Tiranë)

Zhvillimi i vrullshëm i industrisë dhe përdorimi i lëndëve të shumta kimike ka bërë që të shtohen sëmundjet profesionale të lekurës, që kanë lidhje me faktorët e mjedisit. Edhe industria e ndërtimit ka marrë një vrull të madh. Për rrjedhojë, janë vënë re dëmtime profesionale të lekurës në formën e dermatitit dhe ekzemes profesionale.

Sëmundjet profesionale të lekurës përbejnë një problem të rëndësishëm shogëror, sepse ato zënë rreth 50% të të gjithë patologjisë profesionale. Në vetë grupin e sëmundjeve profesionale të lekurës vendin kryesor e zënë dëmtimet profesionale të lekurës te punëtorët e ndërtimit, me rreth 45% të tyre (7,12).

Te këta punëtorë, dermatozat profesionale bëhen shkak paartësie dhe, në qoftë se nuk merren masa mjekuese dhe parandaluese, gojnë deri në invaliditet, prandaj studimi i tyre merr një rëndësi të veçantë.

Te punëtorët e ndërtimit, dermatozat profesionale vijnë si rrjedhojë e kontaktit të gjatë e të vazhdueshëm të lekurës me lëndët kimike që përmban materialin e ndërtimit, kryesisht me kripërat e kromit, kobaltit dhe nikellit dhe e sensibilizimit të organizmit nga ato. Në themel të këtij sensibilizimi qëndron reaksioni antigjen-antitrop (2,3,5,6,7,8,9,12).

Sipas të dhënave spektrografike, përmbajtja e kromit në gimento është 800 µg/2, nikeli 116 µg/2, kobalti 63 µg/2 (14). Ka mendime se kromi ka edhe në përmbajtjen e tullave 8-10% të kromit 6-valent (3). Sig shihet, përmbajtja e këtyre lëndëve kimike në gimento është e pakët, por, kur lekura ka kontakt të vazhdueshëm me to, kjo sasi e vogël është e mjaftueshme për të krijuar në organizëm një gjendje mbisensibilizimi qëndron reaksioni antigjen-antitrop (2,3,5,6,7,8,9,12).

shimi i pH të lekurës në drejtim bazik. Ndryshimi i pH të lekurës prish atësitë mbrojtëse të saj dhe sistemet buferike.

Edhe ndryshimet e gjendjes funksionale fiziologjike të lekurës, siç janë ndryshimi i aftësive neutralizuese të acideve dhe të bazave dhe rezistenca së saj, krijojnë kushte që ndihmojnë për veprimin e mëtejshëm të lëndëve kimike krom-kobalt-nikel dhe shtaqjen e dermatozave profesionale.

Për shtaqjen e dermatozave alergjike profesionale te punëtorët e ndërtimit, kanë rëndësi edhe një sërë faktorësh të tjerë favorizues.

Më kryesoret janë: reaksioni bazik i lartë në gjimnton e lagët; veprimi i saj hidroskopik, që than lekuren dhe prish shtresën korneale; veprimi traumatik dhe gërryes nga partikulat, që ndodhen në gjimnton; mikro-traumat e lekures, të shkaktuara nga vetë materiali i ndërtimit (3). Rëndësi ka edhe veprimi ngacmues i jonave OH⁻, që formohen nga hidratimi i kalciumit, si pasojë e gërrshëmit të gjimntos me ujë (cituar nga 1), dhe nxehësia, që krijohet gjatë hidratimit të saj (cituar nga 1). Edhe marka e gjimntos ndikon, pasi ajo me markë të ulët jep më tepër dëmtime të lekures.

Uji, rëra, granili, që bien vazhdimisht në lekuren e duarve të punës, tërësi në dëmtim, krijojnë kushte që shkaktojnë dëmtim e saj dhe lëndet kimike me veprim sensibilizues që ndodhen në gjimnton thithen më me lehtësi nga lekura e dëmtuar prej tyre.

Si përtundim, faktorët etiologjikë që shkaktojnë lindjen e dermatozave profesionale të punësorët e ndërtimit janë të shumtë, por për caktimin e natyrës profesionale është e domosdoshme që të studiojmë, në tërësi, jo vetëm ndikimin e faktorëve të jashtëm të mjedisit të punës, por edhe gjendjen fiziologjike të lekures dhe të organizmit.

Në këtë studim paragesim studium mbi sëmundshmërinë që kanë dhënë dermatozat profesionale, format klinike të tyre, partitësinë e përkohshme dhe ekzaminimet laboratorike gjatë viteve 1973-1983 të punësorët e 5 kantierëve të ndërtimit «21 Dhjetori» të qytetit të Tiranës, të cilët merren me material ndërtim.

Nepërmyet depistimit aktiv në masë, të organizuar në 6100 depistime të kryera në këtë ndërtim, gjatë 11 vjetëve janë zbuluar dhe ndjekur rregullisht 458 të sëmurë me dermatozat profesionale (dermatit dhe ekzeme profesionale). Nga këta: me ekzeme profesionale 135 ose 29,50% e shumës së përgjithshme dhe me dermatit profesional 323 ose 70,50% e shumës së përgjithshme (Pasqyra nr. 1).

Pasqyra nr. 1

Të sëmurët me dermatozat profesionale sipas diagnozave dhe viteve në ndërtimtarjen «21 Dhjetori»

Diagnoza	1973	1974	1975	1976	1977	1978	1979	1980	1981	1982	1983	Shuma	Përqindja
Dermatit	34	40	43	22	20	39	29	35	25	19	17	323	70,5%
Ekzeme	32	22	27	16	12	11	6	4	2	2	1	135	29,5%
Shuma	65	62	70	38	32	50	35	39	27	21	18	458	100%

Nga të dhënat e pasqyrës nr. 1 del gartë se numri i të sëmurëve me dermatozat profesionale nga viti 1973 në vitin 1983 vjen duke u ulur. Kështu nga 66 të sëmurë që ishin në vitin 1973 numri i tyre bie në 18 në vitin 1983, si rrjedhojë e punës mjekuese dhe profilaktike që është bërë në këtë ndërtimtarje. Të sëmurët me dermatit profesional zënë

afërsisht 3/4 e të sëmurëve me dermatozat profesionale. Për këtë arsye, në kemi shtuar punën tonë depistuese, që të sëmurët me dermatit t'i diagnostikojmë qysh në fazat fillestare të sëmundjes, t'i mjekojmë shpejt dhe mirë, pa i lënë ato që të rtheshin në ekzeme profesionale, sepse këto të fundit janë më të vështira për mjekim.

Duke studiuar dinamiken e sëmundshmërisë përkundrejt fuqisë punësore, sipas viteve, sëmundshmëria ka qenë:

Pasqyra nr. 2

Vitet	1973	1974	1975	1976	1977	1978	1979	1980	1981	1982	1983	
Përqindja	5,1%	4,8	5,2	4,8	2,8	2,4	4,4	3,1	2,58	2,3	1,8	1,4

Nga pasqyra nr. 2, vëmë re se dora-dorës sëmundshmëria vjen duke u ulur; nga 5,10% që ishte në vitin 1973 bie në 1,40% në vitin 1983 — afërsisht 4 herë. Kjo është arritur në sajë të ndjekjes së të sëmurëve, të marrjes së masave parandaluese dhe, kur ka qenë e nevojshme, sisteminimit në punë të përshtatshme të të sëmurëve me dermatozat profesionale.

Gjithashtu, studium shpërndarjen e të sëmurëve sipas tremujorëve dhe vumë re se numri më i madh i të sëmurëve ishte në tremujorin e parë dhe të katërt, gjithësej 258 të sëmurë ose 570% e shumës së përgjithshme.

Rritja e numrit të të sëmurëve me dermatozat profesionale në tremujorin e parë dhe të katërt ka lidhje me faktorët atmosferikë. Punëtore e ndërtimit zakonisht punojnë në mjedis të hapur. Si rrjedhojë, lagështira dhe të ftohtët e stinës së dimrit bëjnë që lekura të thehet, të gahet, të rripet, ndryshime këto që luajnë një rol me rëndësi në patogjenezën e sëmundjeve profesionale të lekures. Ato krijojnë kushte që ndihmojnë në veprimin e metejshëm të gjimntos, rërës, ujit, etj. Në këta tremujorë kemi marrë masa parandaluese, duke përdorur ponada zbutëse, rigjeneruese dhe epitelizuese për të rivendosur gjendjen normale të lekures.

